# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7753 E diel 30 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER edhe sot me e mira ...

Dje në 'Deutsche Welle'

Nga ROBERT SCHWARTZ

## Presidenca rumune e BE-së - Kolaps me pasoja?

Më ndërrimin e viteve, qeveria e mençur rumune nën udhëheqjen e socialdemokratëve të PSD-së, e me gjoks të fryrë nga krenaria do të pushtojë Brukselin...

Vijon në faqen 22

Opinioni i Ditës

Nga ANDI BUSHATI

## Ndryshimet në qeveri, shuplaka e dalë huq

Edi Rama sakrifikoi në mënyrë të pakuptimtë 8 nga 12 ministrat e kabinetit pa arritur të japë asnjë mesazh për publikun dhe sidomos për protestën studentore...

Vijon në faqen 21

PUBLIKOHET LISTA E FAMILJEVE QE MARRIN LEJET NE 11 MINIBASHKITE

# LEGALIZIMET NE TIRANE, EMRAT E 800 PERFITUESVE

Procedura për certifikatën e pronësisë do të ndiqet nga ALUIZNI. Sipërfaqja e legalizuar nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i ndërtimit



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqet 6-8



Lokalet/ Emrat e kandidatëve më 23 mars

# Rama mbledh Kryesinë e PS, porosi të ikurve për zgjedhjet

Ministrat, peng i mbledhjes së Kuvendit deri më 21 janar. Basha: Beteja jonë, me sukses

Kryeministri Edi Rama mblodhi dje Kryesinë e Partisë Socialiste, e cila konfirmoi vendimet e marra dy ditë më parë në Asamblenë e partisë. Në mbledhjen ku u diskutua mbi organizimin e partisë në zgjedhjet lokale, ministrave të larguar iu kërkua angazhim maksimal në zonat përkatëse, pasi siç vetë Rama tha...

Në faqet 3-4

REAGIMI POPULLOR

## Emigrantët në protestë para Kryeministrisë: Shqiptarë, ngrihuni

Në faqen 2

KULTURE

## Tefta Tashko Koço, këngët e padëgjuara dhe regjistrimet në Itali

Në faqen 12

KOMPENSIMI

## Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

Në faqet 9-11

MILOSAO

Meave de Burgh flet për vdekjen e dhjetëra të rinjve që donin të rrëzonin diktaturën

# Agjentja sekrete britanike që admironte shqiptarët

*Në brendësi: Poezi dhe ese nga Eda e Visar Zhiti. "Filmat turq" nga Ben Andoni*

Nga NDREK GJINI

Meave de Burgh jeton vitet e saj të pleqërisë në Wexford të Irlandës. Ajo është ndofta e vetmja grua, ende gjallë, që ka punuar si agjente në shërbimin e fshehtë anglez, gjatë kohës që ky shërbim stërviste të rinj nacionalistë shqiptarë në mërgim, me qëllimin për t'i dërguar me mision në Shqipëri për rrëzimin e regjimit komunist. Në rrëfimin e saj për kanalin më prestigjioz publik të Irlandës, RTE1, Meave de Burgh tregoi...

Suplement

EHW Zgjidhni Cilësinë

Teuta

QAFSHTAMA UJI I SHËNDETIT TË MIRË

GAZETA SHQIPTARE Uron të gjithë lexuesit e saj Gëzuar VITIN E RI 2019

RIKTHEHEMI NE 5 JANAR

## QEVERISJA
### AKUZAT

Banorët e 'Astirit' 56 ditë protestë, kreu i PD: Të largojmë bandën hajdute

# Basha: Beteja që rrëzoi gjysmën e qeverisë 'Rama'

## "Opozita do t'i prijë protestave"



Kryeministri Edi Rama me ministrat e larguar dhe ata të rinj

Valentina Madani



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje me banorët e "Astirit"

**AKUZA**

"Që të rrëzojmë këtë sistem duhet të pastrojmë njëherë e mirë politikën nga krimi. Duhet të pastrojmë parlamentin dhe qeverinë nga politikanët e lidhur me krimin. Duhet të sekuestrojmë pasuritë e oligarkëve të vëna me gjakun dhe djersën e shqiptarëve të thjeshtë",-tha z.Basha.

Protesta te "Unaza e Re" në kryeqytet, shënoi dje ditën e 56-të. Banorët kundërshtojnë prishjen e banesave të tyre siç e parashikon plani për ndërtimin e aksit nga sheshi "Shqiponja" dhe rrëzimin e projektit. Protestuesit lëshuan thirrje kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama. Ata bënë të qartë: "Këtu vendosim ne". Kreu i PD, Lulzim Basha ishte edhe dje në protestën e banorëve të Unazës së Re. Duke shprehur mbështetjen e opozitës për çdo protestë, ai tha se vitin e ardhshëm duhet të nisë beteja për një Shqipëri të zhvilluar. Ai përmendi se nuk mjafton vetëm ndryshimi i disa ministrave, por duhet rrëzimi i Ramës dhe ndryshimi i sistemit politik në vend. Kryedemokrati apeloi që qytetarët të bëjnë qëndresë për të arritur qëllimet e tyre. Kreu i PD-së deklaroi se beteja e banorëve të Astirit arriti që të rrëzonte gjysmën e kabinetit "Rama". Basha tha se ndihet krenar që ishte në krahun e banorëve. "Mund ta themi me gojën plot se kjo qëndresë, e cila nisi në ditët me të errëta të këtyre banorëve, sot së bashku me protestën e studentëve është kthyer në shpresën e çdo shqiptari për një vit ndryshimi të madh. Ky ndryshim do të vijë, do të vijë kur e gjithë Shqipëria të ushtojë, siç ushton unaza. Këtu vendosim ne, këtu vendosin qytetarët. Me këtë shpresë dhe besim ta nisim betejën për një Shqipëri të zhvilluar vitin e ardhshëm me fuqi dhe besim tek njëri-tjetri, me besim tek Shqipëria, tek e ardhmja për veten tuaj dhe për fëmijët tanë. Ky është misioni më i rëndësishëm dhe PD dhe opozita ka sot, të jenë në krah të qytetarëve dhe t'i prijnë protestës qytetare për ta mposhtur të keqen dhe për t'i hapur rrugë Shqipërisë së shpresës dhe besimit", theksoi kreu i PD-së. Sipas tij rruga për t'i kthyer Shqipërinë shqiptarëve është rruga e qëndresës dhe përballjes. "Unaza e Re, Teatri, drama e arsimit të lartë janë simptomat e një sëmundje fatale që ka kapur këtë sistem të kalbur politik. Rruga për ta shembur këtë sistem politik është rruga e qëndresës dhe rruga e bashkimit. Ndonëse janë mbledhur këtu në muzg dhe errësirë, e kanë ndriçuar rrugën me praninë dhe qëndresën. Rruga për t'i kthyer Shqipërinë shqiptarëve është rruga e qëndresës, rruga e përballjes deri në shembje, deri në tullën e fundit çmontimin, deri në vidhën e fundit të këtij mekanizmi që ka vjedhur, shtypur dhe mashtruar shqiptarët dhe rikthimin e demokracisë, shtetit ligjor dhe ekonomisë që ofron vende pune, zhvillim dhe dinjitet për qytetarët shqiptarë",-u shpreh z.Basha. Kreu i demokratëve u shpreh se afera e Unazës së Madhe do të marrë zgjidhje vetëm kur ata që janë përgjegjës të jenë prapa hekurave. Protesta e banorëve tha Basha rrëzoi projektin korruptiv të qeverisë. "Edi Rama kishte bërë gati rrëzimin e shtëpive të mbi 1000 familjeve këtu në Unazën e Re. Nëse këta qytetarë nuk do të ishin bashkuar dhe qëndruar, natyrisht me PD dhe opozitën në krah të tyre, atëherë sot do të ishim përpara gërmadhave të shtëpive të tyre. Por sot jemi prap në protestë para gërmadhave të qeverisë së Edi Ramës. Kjo protestë ndali rrëzimin e shtëpive të tyre, rrëzoi projektin korruptiv, e nxori atë para syve të shqiptarëve dhe botës, si projekti që mishëron modelin e qeverisë së Edi Ramës",- tha z.Basha.

## Organizatori rrëfen udhëtimet me maune drejt Anglisë

## Emigrantët në protestë: Shqiptarë ngrihuni, largoni një orë e më parë diktatorucin

Emigrantët shqiptarë protestuan sërish dje përpara kryeministrisë me thirrje dhe fjalime kundër qeverisjes së vendit. Në mbështetje ishin studentë, aktorë dhe banorët e Astirit e Bregut të Lumit. Emigrantët përçuan mesazhe të qarta për qeverisjen. Ata u shprehën se kryeministri Rama ka mbaruar, ndërsa bënë thirrje që të largohet një orë e më parë kjo klasë politike dhe sistemi zgjedhor, që po mban peng sipas tyre të gjithë shqiptarët. "Ky kryeministër ka mbaruar, ju bëj thirrje gjithë shqiptarëve që të ngrihen e t'i shporrin, te vënë një standard mos i lini më shumë nëse nuk mbajnë premtimet", tha një protestues. Vetë emigrantët deklaruan se edhe diaspora ka kërkesat e saj përkundrejt shtetit shqiptar. "Themeli i demokracisë ka "Shqiptarë mos kini frikë të thoni fjalën e tyre në emër të PD-së. Çohuni shqiptarë mos rrini kafeneve as në 'Facebook', sepse prezenca i kall krupën diktatorëve më të egër jo më këtij diktatoruci" tha me mikrofon aktori i njohur Neritan Lici. Ndërsa studentët mbështetën protestën e diasporës, teksa e komentuan si propagandë shkarkimin e ish- ministres së Arsimit Lindita Nikolla. Genc Sejko, i njohur gjerësisht si njeriu i memeve, ishte iniciator i protestës së emigrantëve. Duke folur para gazetarëve, Genci nuk i mbajti dot lotët, teksa rrëfeu një episod me një 18-vjeçar nga Tirana që kishte marrë rrugën drejt Anglisë. "Para se të vija këtu takova Besin, një djalë nga Tirana, që nuk kishte lekë me hip në maune. U fut nën maune, 18 vjeç dhe thotë kisha shtrënguar aksin nga frika se do të bija. Të gjithë keni fëmijë, të gjithë keni vëllezër, 18 vjeç. Kisha frikë se do kotesha, do bija dhe do bëhesha copa, tha. Për kë është kjo Shqipëri? Ktheni vëmendjen për ata që janë më afër jush. Nuk janë këta, këta e kanë siguruar veten. Kush është më afër jush?",-tha z.Sejko.




## Protesta e diasporës, deputeti i PS: Na hapën barkun

Në një kohë kur emigrantë shqiptarë protestojnë para Kryeministrisë, deputeti i PS-së Pjerin Ndreu përmes një postimi në 'Facebook' ironizon protestën e diasporës, ndërsa i cilëson "emigrantë të bashkisë Kamzë". Në këtë linjë ai ironizoi edhe banorët që preken nga ndërtimi i bulevardit, të cilët edhe dje protestuan për dëmshpërblimet, ndërsa i etiketon si "ca të frymëzuar partiakë". "Emigrantë të bashkisë Kamzë dhe ca të frymëzuar partiakë që kanë humbë vulën e hajdutllekut me ikjen nga pushteti në 2017 i shoh në bulevard! Na hapën barkun t'u harxhu lekë për të mbushë sheshin. Të ndihmonin ndonjë familje në nevojë sa vrerosen pa ditë as ata përse!",-shkruan Ndreu.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Kryesia, zëvendësohen deputetët e bërë ministra, ndarje e re e të deleguarve në qarqe

# Rama porosi ministrave të larguar: Angazhim maksimal për zgjedhjet

## *Lokalet, emrat e kandidatëve me 23 mars*

Kryeministri Edi Rama mblodhi dje Kryesinë e Partisë Socialiste, e cila konfirmoi vendimet e marra dy ditë më parë në Asamblenë e partisë. Në mbledhjen ku u diskutua mbi organizimin e partisë në zgjedhjet lokale, ministrave të larguar iu kërkua angazhim maksimal në zonat përkatëse, pasi siç vetë Rama tha në Asamble, në territor kjo forcë çalon. Socialistët u mblodhën dje dhe diskutuan axhendën politike deri në zgjedhjet lokale të vitit 2019. 180 ditë përpara zgjedhjeve, socialistët nuk do të humbasin asnjë ditë për të filluar fushatën për të arritur fitoren në këto zgjedhje. Menjëherë pas pushimeve të fundvitit, që nga data 4 janar do të fillojnë mbledhjet e organizatave socialiste për t'u reformuar sipas porosive që Kryeministri la në Asamble. Puna e të gjitha strukturave duhet të përfundojë përpara datës 23 mars, kur do të mbahet edhe Kongresi elektoral i Partisë Socialiste nga ku me gjasë do të publikohen emrat e kandidatëve socialistë për kryetarë bashkie. Po ashtu, edhe kryesia e Partisë do të mblidhet çdo javë në funksion të zgjedhjeve duke qenë se viti i ardhshëm është një vit elektoral. Në mbledhjen e Kryesisë, sekretari i Përgjithshëm Taulant Balla bëri me dije se pasi të bjerë dakord me kryesinë e grupit socialist, do të propozojë emrat që do të zëvendësojnë nëpër komisione parlamentare deputetët e bërë ministra, ndërkohë që emrat e ministrave të rinj ende nuk kanë shkuar tek presidenti i Republikës për t'u dekretuar. 2 prej tyre ishin kryetarë komisionesh, Eduard Shalsi tek Veprimtaria Prodhuese dhe Erion Braçe tek Ekonomia. Në vend të Erion Braçes, drejtimin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pritet ta marrë Arben Ahmetaj, i cili largohet nga qeveria, ndonëse nuk përjashtohet as Ervin Bushati. PS duhet të zëvendësojë edhe Eduard Shalsin në krye të Veprimtarisë Prodhuese dhe Bledi Çuçin si n/kryetar i Komisionit të Integrimit dhe Bashkëkryetar i Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Vendimet e tjera të Asamblesë ishin ngritja e grupit të punës për ndryshimin e statutit dhe miratimi i kalendarit 6 mujor për përgatitjen e strukturave socialiste për zgjedhjet lokale. Kur mbeten 180 ditë nga zgjedhjet, fokusi i mbledhjes së Kryesisë, që zgjati rreth një orë, ka qenë te përgatitja për garën e ardhshme elektorale. Pushimet e socialistëve do të jenë të shkurtra dhe kalendari nis shpejt. Makineria organizative e PS-së do të vihet në lëvizje që më 4 janar, me mbledhjen e Këshillave të Koordinimit në territor, me një kalendar përgatitjesh që përfundon me thirrjen e Kongresit më 23 mars. Kryesia ka vendosur që deri në kongres socialistët të kenë ndarë përfundimisht cilët do të jenë kryebashkiakët që do të rikandidojnë e cilët do të zëvendësohen. Kryeministri Rama tre ditë më parë zhvilloi gjatë pasdites një mbledhje informale me anëtarë të kabinetit qeveritar, në të cilën merrnin pjesë si ministrat e larguar dhe ata të emëruar. Ndryshimet prekën 8 ministri, të cilat u zëvendësuan me emra të rinj.



Mbledhja e Kryesisë së Partisë Socialiste

**ZËVENDËSIMET**
Në vend të Erion Braçes, drejtimin e Komisionit të Ekonomisë pritet ta marrë Arben Ahmetaj, i cili largohet nga qeveria, ndonëse nuk përjashtohet as Ervin Bushati. PS duhet të zëvendësojë edhe Eduard Shalsin në krye të Veprimtarisë Prodhuese dhe Bledi Çuçin si n/kryetar i Komisionit të Integrimit dhe Bashkëkryetar i Komisionit për Reformën Zgjedhore.

**OLTA XHAÇKA**
23 ushtarakë të gradave të ndryshme dhe 3 civilë që punojnë në strukturat e Forcave të Armatosura u nderuan dje me medalje nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Sipas saj njerëzit janë pasuria më e madhe në FA.

## Rama publikon foton nga mbyllja e basteve: Lamtumirë!

Duke filluar nga 1 janari 2019, lotot e sportit do të jenë të ndaluara me ligj. Ditën e djeshme mbyllën aktivitetin edhe ato pika bastesh e lotosh, të cilat shfrytëzonin aktivitetin e tyre deri ditët e fundit të vitit para se të hyjë ligji në fuqi. Kryeministri Edi Rama publikoi dje një foto në 'Facebook' të një bar lotoje teksa shfaqen punonjësit që heqin tabelën e një kompanie bastesh sportive. "Lamtumirë"- shkruan Rama në foton e publikuar në rrjetin social. Kujtojmë se qeveria ka marrë vendim për të mbyllur brenda datës 31 dhjetor 2018 kazinotë elektronike, bingot tradicionale dhe bastet sportive në qendrat e banuara. Sipas të dhënave zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit deri më datën 23 dhjetor në të gjithë vendin janë mbyllur 5220 pika bastesh sportive ndërsa 331 pritet të mbyllen. Pas mbylljes së basteve sportive qeveria ka thënë se do të marrë përsipër që të kryejë një program rikualifikimi për ata që do të mbeten të papunë.




## Pas shkarkimit nga detyra, Bushati takon të moshuarit

Kryeministri Edi Rama e largoi nga detyra e minis trit për Europën dhe Punët e Jashtme, por Ditmir Bushati nuk është ndalur nga angazhimet e tij. Ai ishte dje në shtëpinë e pushimit të të moshuarve në Shkodër, ku ka marrë pjesë në një festë të organizuar për ta me rastin e fundvitit. Ka qenë vetë Bushati që ka postuar edhe disa foto. "Një ditë të këndshme festive në shtëpinë e pushimit të moshuarve në Shkodër. Ju urova festat e fundvitit duke shprehur mirënjohjen e pafund për këtë brez të shoqërisë, që na japin shembullin e sakrificës. Gëzuar2019!",-shkruan Bushati. Ai u zëvendësua nga Genti Cakaj.

## Denoncimi i PD-së: 34 mijë mësues pa asnjë shpërblim

Deputeti i PD-së Luçiano Boçi akuzoi dje se Kryeministri Rama u mohoi mbi 30 mijë mësuesve shpërblimet për vitin e ri, duke dhunuar të drejtën që e kanë të fituar me ligj. Sipas tij e vetmja alternativë për sistemin arsimor në Shqipëri është Partia Demokratike. "Qeveria e Edi Ramës ka vendosur një rekord të ri në keqtrajtimin, përçmimin dhe denigrimin e mësuesve gjatë këtyre 5 viteve të fundit. Që kur ka ardhur në pushtet e deri më sot, Edi Rama nuk ka dhënë asnjë shpërblim për fundin e vitit për 34 mijë mësues në arsimin parauniversitar. Edhe këtë vit, qeveria që paguan 105 milionë euro për koncesionet e oligarkëve, nuk ka asnjë qindarkë për të shpërblyer mësuesit e Shqipërisë. Duke mos u dhënë shpërblimin e fundvitit 34 mijë mësuesve, qeveria shkel kontratën kolektive të firmosur mes Ministrisë Arsimit dhe Sindikatave. Në nenin 10 të kontratës thuhet se "punëdhënësi, që në këtë rast është qeveria, u njeh sindikatave të drejtën për shpërblimin vjetor të mësuesve në sistemin publik parauniversitar",-tha z.Boçi. Ai foli për alternativën e PD-së. "Ne jemi të qartë për vizionin tonë: Mbështetje financiare për arsimin, shpërblimin dhe rritjen e pagave për mësuesit, investim për infrastrukturë moderne, subvencionim për tarifat e studentëve, stazh të paguar për 10 mijë studentë çdo vit. Partia Demokratike ka të gjithë vullnetin për ta nxjerrë sistemin arsimor nga kriza dhe për të shkuar me vendosmëri drejt zhvillimit",-theksoi deputeti i PD-së.



Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi

NDRYSHIMET
OPOZITA

Ndryshimet në qeveri, PD: Prej betejave tona, ata që ikin do përballen me drejtësinë

# Ministrat do presin për dekretimin. Kuvendi mblidhet më 21 janar

## *LSI: 7 xhuxhët në qeveri si gromësima e Ramës*

Valentina Madani

Emrat e ministrave të rinj ende nuk kanë shkuar tek Presidenti i Republikës për t'u dekretuar. Ministrat do presin për dekretimin nga Presidenti Meta pasi Kuvendi do të mblidhet më 21 janar. Burime në Presidencë bëjnë me dije se emrat e ministrave të rinj nuk kanë mbërritur ende në tryezën e kreut të shtetit ndërkohë që nga qeveria shpjegojnë se nuk ka arsye për nxitim, pasi edhe nëse ministrat dekretohen brenda ditës nga Presidenti Meta, për miratimin e tyre në Parlament duhet të pritet nisja e sesionit të ri parlamentar më 21 janar.

**OPOZITA**

Ndryshimet në qeverinë "Rama", opozita i sheh si rezultat i betejave të saj kundër krimit dhe korrupsionit. I pranishëm në Korçë, me rastin e 28-vjetorit të themelimit të degës lokale të PD në këtë qytet, deputeti i PD-së Ervin Salianji e cilësoi ndryshimet në qeveri si një lajm të mirë, pasi sipas tij u larguan të gjithë ministrat e akuzuar nga opozita. Mes të tjerash Salianji tha se ky është hapi i parë i fitores së betejave opozitare për të larguar qeverinë. "Për Korçën është një lajm i mirë ndërprerja e projektit personal të Niko Peleshit, për të kontrolluar qytetin bashke me një grup biznesmenësh afër tij. Për Shqipërinë, pa diskutim është një lajm i mirë, që largohen gjithë ministrat e akuzuar nga opozita, që kanë pasur afera të rënda korruptive. Ky është hapi i parë i fitores së betejave opozitare për të larguar qeverinë. Hapi tjetër, duket që e ka ndërmarrë vetë Rama, për të kaluar në një qeveri tranzitore, deri në dorëzimin përfundimtar të pushtetit. Lajmi i keq për Shqipërinë është, që edhe në këto muaj do të qeveriset nga një qeveri tërësisht familjare qeveri e familjes së Ramës, bashkëshortes apo ish-bashkëshortes së Ramës dhe duket që në mënyrë të turpshme edhe në 2018, nuk është tejkaluar një fazë, që u mbyll në 2005, që ministrat, që vijnë në periudhën e fundit te pushtetit, për të vjedhur dhe plaçkitur çfarë ka mbetur. Është e sigurt, që asnjë nga ministrat e larguar, përfshi edhe Niko Peleshin, nuk do t'i shpëtojë drejtësisë dhe SPAK-ut, por edhe me amendimet kushtetuese dhe ligjin antimafia që ka propozuar PD. Dy ministrat e tjerë, Spiropali dhe Shalsi, nuk asnjë përfaqësimi ne qytetin e Korçës. Njeri është kapur duke thënë 'vjedhim me lezet', ndërsa tjetra, e di gjithë Kolonja, se si shkon bashkëshorti i saj, me çantë në Ersekë, për të marrë pagesat një herë në muaj. Ata nuk janë aty për ndonjë projekt politik, por për t'i shërbyer Edi Ramës", tha Salianji. Kurse kreu i grupit parlamentar të LSI-së Petrit Vasili, i konsideroi "xhuxha" ministrat e rinj të qeverisë që u caktuan nga Edi Rama në Asamblenë e Partisë Socialiste. "7 xhuxhat e rinj në qeveri si teshtima dhe gromësima e Ramës? 7 xhuxhat e rinj në qeveri kanë një meritë të madhe se gajasen dynjanë me hiçgjë-në, që përfaqësojnë. 7 xhuxhat janë thjesht teshtima dhe gromësima e radhës e Edi Ramës. 7 xhuxhat e rinj të qeverise kanë vlerë dhe mund të zgjasin aq sa zgjat një gromësimë. Llogarinë e hapur Edi Rama e ka me shqiptarët dhe jo me 7 xhuxha po as me 17 fatin e tij nuk e ndryshon dot, se qindra milionë eurot e grabitura nga ai kërkojnë shpagim që fillon nga burgu. As xhuxhat as breshkat nuk ia sjellin dot frymën Edi Ramës, se sado që merr frymë nga lart i del e gjitha nga poshtë se është shpuar krejt",-u shpreh z.Vasili.



Deputeti i PD-së Ervin Salianji

**DEKRETI**

Emrat e ministrave të rinj nuk kanë mbërritur ende në tryezën e kreut të shtetit ndërkohë që sipas qeverisë nuk ka arsye për nxitim, pasi edhe nëse ministrat dekretohen brenda ditës nga Presidenti Meta, për miratimin e tyre në Parlament duhet të pritet nisja e sesionit të ri Parlamentar më 21 janar.

## Kryemadhi ftesë socialistëve: Bashkohuni me LSI, ikni nga sekti kriminal!

Kryemadhi u bëri dje ftesë të gjithë socialistëve të ndershëm që të bashkohen me LSI. Gjatë një takimi me strukturat e LSI në Vlorë, Kryemadhi deklaroi se ata ndihen më të shfrytëzuar, ndaj janë të gatshëm të rrëzojnë qeverinë. "Përveçse ka rënë qeveria e Surrelit, njerëzit që ndihen më të frustruar, më të nervozuar dhe më të inatosur janë socialistët e ndershëm. Janë socialistët e ndershëm, sepse janë ata që ndihen të përdorur dhe të shfrytëzuar. Janë socialistët e ndershëm që e kanë të domosdoshme riorganizimin e PS. Por ata nuk mund të presin riorganizimin nga një sekt kriminal, por ata janë të gatshëm për të vepruar dhe veprimi i tyre është për të rrëzuar këtë qeverisje, që nuk është gjë tjetër veçse një strukturë kriminale që mundohet të mbulojë me parfum erën e keqe. Prandaj ju bëj thirrje sot që detyra e LSI në Vlorë, nuk është thjesht për të organizuar strukturat e saj në të gjithë Bashkinë e Vlorës, por për të hapur dyert dhe për t'u bërë mikpritës të gjithë atyre socialistëve të ndershëm, të cilët nuk e gjejnë më veten pranë këtij sekti kriminal",-tha Kryemadhi.





Ministrat e rinj

**NDRYSHIMET**
Ndryshimet në qeverinë "Rama", opozita i sheh si rezultat i betejave të saj kundër krimit dhe korrupsionit. I pranishëm në Korçë, me rastin e 28-vjetorit të themelimit të degës lokale të PD në këtë qytet, deputeti i PD-së Ervin Salianji e cilësoi ndryshimet në qeveri si një lajm të mirë, pasi sipas tij u larguan të gjithë ministrat e akuzuar nga opozita.



## Patozi ironizon qeverinë: Më lehtë importojmë ministra nga Kosova sesa patate

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Astrit Patozi, nuk e kursye dje ironinë lidhur me ndryshimet e fundit në kabinetin qeveritar. Marrë shkas nga fakti se dy ministri jo pak të rëndësishme, ajo e Arsimit dhe e Punëve të Jashtme iu besuan dy shqiptarëve nga Kosova, Patozi shprehet se Shqipëria e ka më lehtë të importojë ministra sesa patate, sepse për të parët të paktën nuk paguhen taksa. "Më pyeti një mik se si më dukeshin ndryshimet e fundit ne qeveri. - Po çfarë të them unë?- iu përgjigja. Është fakt që për çështjen kombëtare kemi bërë hapa të rëndësishëm përpara. Falë timonierit, tani nga Kosova është më e lehtë të importosh ministra, se sa të sjellësh në Shqipëri patate (kumpira i thonë në Kukës dhe Prizren). Sepse për të parët, të paktën nuk na duhet të paguajmë taksa", - theksoi-ish deputeti i PD-së Astrit z.Patozi.

Bashkia: Vendimi në konflikt interesi, të shpallet i pavlefshëm!

# Kryebashkiaku Veliaj padit sërish kryetarin PD-së, Lulzim Basha për shpërdorim detyre

## "I dha leje vetes për ndërtimin e një kati shtesë në pallatin ku banon, në kundërshtim me ligjin"

TIRANË

Pak ditë pas padisë për shpifje, kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha është paditur sërish nga kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj. Këtaj here Veliaj e akuzon kryedemokratin për shpërdorim të detyrës (gjatë kohës që i drejtonte bashkinë, pasi e akuzon se i ka dhënë vetes leje për ndërtim të një kati shtesë në kundërshtim të hapur me ligjin për konfliktin e interesit.

Në njoftimin për shtyp të Bashkisë, ky institucion i kërkon gjykatës: "Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Vendimit nr. 9305/9, datë 01.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Lejes së Ndërtimit nr. 9305/12, datë 25.08.2014 për strukturën "Shtesë 1 kat mbi strukturën ekzistuese 1 kat", në rrugën "Skerdilajd Llagami" për pronën e regjistruar me nr. 6/121+2-29, ZK 8160, vol 22, faqe 90, pranë ZVRPP Tiranë në bashkëpronësi të Lulzim Bashës dhe bashkëshortes së tij Aurela Isufi (Basha) me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë "ARCHIMED INTERNATIONAL" shpk".

Në kërkesë padinë e depozituar në Gjykatë, Veliaj pretendon se Basha ka nxjerrë akte administrative për interesa private të tij, të cilat sipas tij lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin dhe tjetërsimin e pasurisë në pronësi të tij dhe të bashkëshortes.

"Në rastin konkret ishkryetari i Bashkisë, Z. Lulzim Basha për një proces të rregullt ligjor dhe për vendimmarrje të drejtë dhe të paanshme, ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi organi publik do të vendoste për një leje zhvillimore ndërtimi për shtëpinë e banimit të tij dhe bashkëshortes duhet të mënjanohej dhe të zgjidhte pa asnjë hezitim të vetëpërjashtohej paraprakisht nga procesi i vendimmarrjes dhe të delegonte këtë të drejtë tek zëvendësit e tij. Në të njëjtën linjë ka qenë dhe opinioni i institucionit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, ku në kthim përgjigje për Bashkinë e Tiranës, i është drejtuar duke i ilustruar një rast konkret, nëpërmjet manualit të konfliktit të interesave në pushtetin vendor, ku një kryetar komune, në cilësinë e anëtarit të KRRT-së së komunës nuk ka marrë pjesë në votim në miratimin e lejes së ndërtimit për vëllanë e tij. Në këtë rast leja është miratuar me shumicë votash të anëtarëve të KRRT-së dhe kryetari i komunës ka nënshkruar vetëm aktin final të zbardhjes së lejes së ndërtimit",-thuhet më tej në padi.





Kreu i PD-së, Lulzim Basha


Kryebashkiaku Erion Veliaj

**KONFLIKTI I INTERESIT**

Kreu demokrat Basha në funksionin e kryetarit të bashkisë Tiranë gjatë viteve 2011-2015, në shumë raste të tjera, në mungesë dhe porosi, ka deleguar kompetencën për dhënien e lejes së ndërtimit, zëvendëskryetarit të bashkisë. Pra, çka nënkupton që kjo nuk është një kompetencë që nuk mund të delegohet dhe mbi të gjitha në këtë rast, gjendur përpara konfliktit të hapur të interesit, i padituri, thotë bashkia e Tiranës, duhet të kishte deleguar dhënien e lejes së ndërtimit, në favor të bashkëshortes dhe vetes së tij, te njëri prej zëvendëskryetarëve të Bashkisë Tiranë.

**PADIA E PARË PËR SHPIFJE**

Pak ditë më parë kryebashkiaku Erion Veliaj depozitoi në gjykatë padinë e parë kundër Lulzim Bashës dhe deputetes së PD-së, Jorida Tabakut për lejet e ndërtimit që i dhanë vetes dhe akuzat e bëra lidhur me devijimin e rrjedhës së lumit të Lanës dhe projektit të Unazës së Re. Veliaj i cilëson akuzat tërësisht të pavërteta dhe pa asnjë provë. Në bazë të padisë së bërë, kryebashkiaku Veliaj kërkon detyrimin që të padituri të shpërblejnë dëmin jo pasuror shkaktuar ndaj tij me deklaratat publike të ditëve të fundit në shumën 100.000 mijë lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore dhe ato avokatore. Bashkia e Tiranës i ka përgënjeshtruar disa herë deklaratat e Bashës dhe Tabakut lidhur me projektin në fjalë, duke theksuar se nuk ka miratuar asnjë leje ndërtimi në atë zonë.

## Dyshohet që ekzekutori ndodhet në Tiranë

### Policia në gjurmët e vrasësit të Griseldës, kontrolle në disa ambiente gjatë natës

**TIRANË** - Policia e Tiranës ka rënë në gjurmët e autorit të vrasjes së 17-vjeçares Griselda Gjikolës dhe plagosjes së mikut të saj Erion Bengo. Burime nga blutë konfirmuan për Tv Klan se gjatë natës të së premtes janë bërë kontrolle në disa ambiente, por autori i krimit nuk është mundur të arrestohet. Policia dyshon se 19-vjeçari ndodhet në Tiranë dhe kërkimet për të kanë vazhduar edhe ditën e djeshme. Në pranga për këtë krim ka rënë Ronald Muzhaqi, i cili dyshohet se është personi që e ka ndihmuar autorin të largohet nga vendi i ngjarjes. Të dy janë fiksuar nga kamerat e sigurisë teksa po largoheshin me vrap nga vendi i krimit. Muzhaqi pritet të dalë sot para gjykatës ku do të njihet me akuzën e përkrahjes së autorit të krimit. Policia ka marrë në pyetje edhe personat që kanë qenë në makinë bashkë me 17-vjeçaren dhe të dashurin e saj. Erion Bengo u tha hetuesve se konflikti me autorin e krimit kishte nisur 10 ditë më parë në një lokal, pasi ai kishte ngacmuar Griseldën. Më pas ishin qëlluar me grushte për 17-vjeçaren për të cilën, Bengo pretendon se ka patur vetëm lidhje miqësore.





## Mesazhe kundër Krishtlindjeve, 33-vjeçari shqiptar dëbohet nga Italia

**ITALI** - Një 33-vjeçar shqiptar, i cili që prej 14 vitesh jetonte në Padova e ka pësuar keq nga autoritetet italiane, pasi është dënuar nga shteti fqinj për shkak të disa mesazheve kundër Krishtlindjeve. Mediat italiane bëjnë me dije se Shaban Cacës, i është ndaluar hyrja në Itali për 10 vite. Ai cilësohet si eksponent i rrezikshëm për terrorizmin dhe nxitës i urrejtjes sociale. Mësohet se 33-vjeçari nga Kavaja është marrë nga shtëpia, është transferuar në stacionin e policisë dhe më pas është dëbuar e shoqëruar në Tiranë, me një fluturim nga aeroporti 'Malpensa' në Milano. Përmes faqes së tij të 'Facebook', shqiptari akuzohet se kishte publikuar disa mesazhe kundër festimit të Krishtlindjeve, shkruan 'Mattinopadova'. Lajmi në fjalë është bërë me dije nga Ministria e Brendshme italiane. Ndërkohë vetë ministri Matteo Salvini ka deklaruar se: "Në Itali nuk ka më hapësirë për këdo që përpiqet të sjellë luftën brenda shtëpisë sonë". Ndërkaq, Shaban Caca i kontaktuar nga media italiane "Il Mattino", është shprehur se ndonëse është mysliman dhe frekuentonte xhamitë, kurrë nuk ka pasur probleme me drejtësinë.

## Aksident tragjik në Itali, plagosen rëndë 4 shqiptarë

Një aksident i rëndë ka ndodhur dje në Itali, ndërsa janë plagosur 4 shqiptarë, mes të cilëve edhe një fëmijë 6-vjeçar. Dy makina janë përplasur rreth orës 9:15 përgjatë rrugës Prati, në komunën Santorso. Në njërin nga mjetet udhëtonte një shqiptar 38-vjeçar, gruaja e tij si dhe djali 6-vjeçar, të cilët janë dërguar në spitalin San Bortolo të Vicenza. Djali i tyre, 6 vjeçar për shkak të plagëve u transportua me helikopter në Verona. Sakaq në mjetin tjetër që u përshi në aksident udhëtonte, gjithashtu, një shqiptar 44-vjeçar me banim Piovene, i cili ka mbetur i plagosur. Ndërkaq, mësohet se nuk dihen ende shkaqet dhe e aksidentit.

Informalët/ Sipërfaqja e legalizuar nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i ndërtimit

# Legalizimet, lista me 800 emra në Tiranë

## *Procedura për certifikatën e pronësisë do të ndiqet nga ALUIZNI*



ALUIZNI publikon listën me 800 pronarët që kanë gati lejen e legalizimit në qytetin e Tiranës.

Bazuar te ndryshimet e fundit ligjore, qytetari duhet të marrë një kopje për të vërtetuar përmbarimin e procesit të legalizimit. Ndërsa, lidhur me procedurën vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ajo do të bëhet nga Agjencia.

**TAPIA**

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit, dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shitet poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë, përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

### LISTA EMERORE ME PERFITUESIT E LEGALIZIMEVE NE TIRANE

| Emri Atësia Mbemri | Njesia |
|---|---|
| BAJRAM MUHARREM META | 11 |
| CELNIK HAMZA HAZIZI | 11 |
| SHABAN QEMAL CANO | 11 |
| IBRAHIM SELIM HALA | 11 |
| ASTRIT FAIK CERMA | 11 |
| MARK LUSH STEAJ | 11 |
| ILIA JAK NDREPEPAJ | 11 |
| RAKIP GANI ALLA | 11 |
| BESNIK TAHIR FILJA | 11 |
| NIKOLL NDREC LLESHI | 11 |
| REFAT IZET CAMI,FLORIAN | |
| REFAT CAMI | 11 |
| SAMI GANI MURATI | 11 |
| DERVISH HAXHI DOCI,XHELAL | |
| DERVISH DOCI11 | |
| SELMAN AJAZ ISTREFI | 11 |
| RAMIZ ADEM XEKA | 11 |
| BAFTJAR HASAN MUSABELLIU | 11 |
| ARBEN PELLAN MOLLANJI | 11 |
| PERPARIM ISMAIL CEJKU | 11 |
| HAJRI AHMET MUCA | 11 |
| PETRIT LEKE HASAJ | 11 |
| AISHE ISUF LACI,DRITERO | |
| XHEMAL LACI,SOKOL XHEMAL | |
| LACI,ALTIN XHEMAL LACI | 11 |
| BESNIK ISUF LUSHNJA | 11 |
| ELTON AGIM KALECI | 11 |
| LAVDURIM XHEMAL CAMI | 11 |
| BASHKIM HASAN SITA,NAZMI | |
| HASAN SITA | 11 |
| ARBEN BEXHET MEKA | 11 |
| ELMAZ SHABAN SULA | 11 |
| NAIM ZYBER MANREKA | 11 |
| AGIM PAL PEPKOLAJ | 11 |
| VESEL HAXHI IMERI | 11 |
| FATIME IDRIZ CANO | 11 |
| HAMDI SINAN META | 11 |
| HAMIT ALI BRUCI | 11 |
| MUSTAFA RESHIT LACI | 11 |
| REFIK MEXHIT SORRA | 11 |
| NAZMI HATE HASANLLARI | 11 |
| DEDE ZEF GECAJ | 11 |
| ARBEN REXHEP BUSHI,REXHEP | |
| FASLI BUSHI | 11 |
| AGRON VEHAP XHEKA | 11 |
| LAZER KOLE QEHAJA | 11 |
| XHEMILE XHAFERR LEKA | 11 |
| VIKTOR PAL DELIA,ARTAN LEK | |
| NDREKAJ,PJERIN PAL DELIA, | |
| LULJETA LEKE DELIA | 11 |
| DRITAN HALIM ZHLLIMA | 11 |
| MERE MURSEL MUSTAFAJ | 11 |
| GJEVALIN MARK BUSHGJOKAJ | 11 |
| LUAN FERIT XHEJA,MIRELA | |
| IBRAHIM XHEJA | 11 |
| BARDHOK PAL BUCAJ,MARK | |
| PAL BUCAJ | 11 |
| SHYQYRI BAJRAM KADRIA | 11 |
| MEZARKO ALI AVXHI | 11 |
| SULI RIZA SHKEMBI,FATJON | |
| ADEM MERO | 11 |
| ZIADIN SINAN SPAHIU | 11 |
| HASAN GANI PIRA | 11 |
| VATE CUN PREKPERAJ | 11 |
| LEZE PAL UKCENAJ,GEZIM PAL | |
| UKCENAJ 11 | |
| SIMON DEDE GECAJ | 11 |
| BIBE CUN GECAJ CUN KOL | |
| GECAJ | 11 |
| ASTRIT NDOC NDRECPECAJ | 11 |
| HAMET SAFE HASANLLARI | 11 |
| DOD PRENG JAKU | 11 |
| BEXHET NURI CAMI | 11 |
| BENIZ FRAN DODA | 11 |
| RROK TOM CARDAKU | 11 |
| FATMIR SHABAN PAJTONI | 11 |
| FLAMUR BIDO LLAPUSHI | 11 |
| ABAZ ZYBER MANREKA | 11 |
| BASHKIM GANI DUKA GANI | |
| SHABAN DUKA | 11 |
| SULEJMAN HET MURATI ILIR | |
| HET MURATI | 11 |
| ZYBER ABAZ MANREKA | |
| SHPETIM ZYBER MANREKA | |
| DONIKA SKENDER MANREKA | 11 |
| XHEMAL OSMAN SULA | 11 |
| RAZIM HAZIS META | 11 |
| LIMAN HALIL GJOKA | 11 |
| MEHMET BESNIK KULEMANI | 11 |
| XHEMAL ALI HIDA | 11 |
| FATOS HALIM LILA | 11 |
| AMIR ALI PEPOSHI | 11 |
| SHYQYRIE BESHIR MARKU | 11 |
| ISLAM MYSLIM HAKCANI | 11 |
| PASHK UKE ALIA | 11 |
| ENVER STAF PERHALI | 11 |
| ALBERT QANI KAJA | 11 |
| ENVER KAMBER SALLAHI | 11 |
| SKENRDINAND QANI KAJA | 11 |
| IBRAHIM RAMAZAN LIKZELIA | 11 |
| KADIFE ALI HAKA | 11 |
| XHEMAL SHERIF TROCI | 11 |
| IDAET NURI SHUKULLI | 11 |
| DED LULASH NIMANI | 11 |
| ISMAIL RIZA SHEHI,LUAN | |
| ISMAIL SHEHI | 11 |
| RUSHIT FADIL ELEZI | 11 |
| QOSE 11 | |
| NAIM ALI SINA | 11 |
| GJELOSH KOKER PREBIBAJ | 11 |
| REFIK BEQIR HOXHA | 11 |
| RAMIZ XHEMAL LUSHNJA, | |
| SAJMIR RAMIZ LUSHNJA | 11 |
| BISLIM AZEM AJDINI | 11 |
| DRITAN FIQIRI BUSHI | 11 |
| ISTREF SELAM DOMI | 11 |
| ISMET MUHARREM ZISKO | 11 |
| XHAFER AHMET MULGECI, | |
| CAN AHMET MULGECI | 11 |
| AMIR SINAN SPAHIU | 11 |
| KOL GJERGJ QUNI | 11 |
| PERPARIM SHERIF BULKU | 11 |
| ZYHDI ZENEL SIPRI | 11 |
| NAIM XHEMAL RRASA | 11 |
| XHAVIT RIFAT SUFAJ,ARBEN | |
| XHAVIT RECI,LAURENT XHAVIT | |
| SUFAJ | 11 |
| PJETER MHILL ALIJA,PASHUK | |
| PJETER ALIJA,GJOVALIN | |
| PJETER ALIJA FERIT PJETER | |
| ALIJA 11 | |
| BEGLIE RIZA BATALI | 11 |
| RASIM IBRAHIM MEHIDRI, | |
| IBRAHIM ALI MEHIDRI | 11 |
| REXHEP HASAN SHEHU | 11 |
| LEKE MARTIN LEPEJA | 11 |
| RAMAZAN XHEVDET BOSHKU | 11 |
| FERIT XHEMAL ZHUZHI | 11 |
| HASHIM MAN DRAGJOSHI | 11 |
| TEUFIK RIZA COLLAKU | 11 |
| ARJAN GJOKE RRAHI | 11 |
| SELMAN RIZA TANUSHI,SHAHE | |
| LIMAN TANUSHI | 11 |
| NIKO MYSLIM VILA | 11 |
| IBRAHIM MURAT KUNXHIU | 11 |
| RUTE KOL KACI,XHEVAIR ESAT | |
| KACI,GENTIAN ESAT KACI, | |
| ENGEL ESAT KACI | 11 |
| MURAT AVDI FIDA | 11 |
| DRITA JONUZ RAMA | 11 |
| ENVER ISLAM MISKU | 11 |
| ROMEO DANIELA HODO,A | |
| FERDITA HODO | 11 |
| ILIR SHEFQET SHEHAJ | 11 |
| GJON LLESH DOCI | 11 |
| PASHK LUSH MARKU | 11 |
| ALI FAIK RAMA | 11 |
| ENGJELL AVNI MATA | 11 |
| PREKE PALI PERPELAJ | 11 |
| KADRI FUAT ALUSHI | 11 |
| ZAIM HYSEN VESELI | 11 |
| FERIT SHAQIR BOSHKU | 11 |
| ILMI MURAT BOSHKU | 11 |
| ALLAMAN IBRAHIM DOKU | |
| MENTORALLAMAN DOKU | |
| FESTIM ALLAMAN DOKU | 11 |
| PJETER GJOK DEMAJ | 11 |
| LUAN ABAZ SHEHU | 11 |
| SHKELQIM IBRAHIM GJOKA | 11 |
| ARJAN QAMIL SEJDINI | 11 |
| HAMZA SABRI LILA | 11 |
| MIMOZA ENVER ZYBERAJ | 11 |
| RUSTEM SELMAN RRUSHI | 11 |
| FATMIR SALI PLAKU RUDINA | |
| SEJDIN PLAKU | 11 |
| HALIM SHABAN BRIJA | 11 |
| ALBAN XHAFER BALLA | |
| DEZDEMONA GJIN BALLA | 11 |
| FATMIR MARK SUSAJ | 11 |
| LULEZIME NEZIR DURA | 11 |
| MARK ZEF VUKZA | 11 |
| ARBEN HAXHI SULAJ ARDIAN | |
| HAXHI SULAJ | 11 |
| PERPARIM VEHAP XHEKA | 11 |
| MOJSI OSMAN TURJAN | 11 |
| ILIR MEHDI HYSA | 11 |
| PETRIT RAMADAN SHERIFI | 11 |
| XHEVDET RAMADAN CANE | 11 |
| BESIM RUSTEM MANSAKU | |
| ASTRIT BESIM MANSAKU | |
| SARARUSTEM MANSAKU | |
| RENATA XHEVDET MANSAKU | |
| MARIGLEN RUSTEM MANSAKU | 11 |
| KUJTIM MULI BASHA, EDIP | |
| MULI BASHA | 11 |
| GJOVALIN PJETER QOKAJ | 11 |
| ASTRIT HAMDI PUCI | 11 |
| FAIK DEMIR BLUSHI | 11 |
| YLLI ENVER PRAPA | 11 |
| SERVETE MUHAMET BENGO | 11 |
| KLODIAN HYSNI TAKACI | 11 |
| KRISTAQ BEQIR VOGLI | 11 |
| ISMAIL GANI LALA | 11 |
| ALTIN BAJRAM PULA | 11 |
| NAZMI HAMDI SUKITHI | 11 |
| FAIK DEMIR BLUSHI | 11 |
| YLLI ENVER PRAPA | 11 |
| SERVETE MUHAMET BENGO | 11 |
| ALI SHABAN MADANI | 11 |
| SHYQYRI OSMAN DEMA | 11 |
| ANESTI HAKIL ZGURO, JETNOR | |
| ANESTI ZGURO | 11 |
| ESAT RAHMAN KURTEJ | 11 |
| ALI BIB FIRI | 11 |
| MURAT XHELADIN BEQIRI | 11 |
| GEZIM SUL DEMA | 11 |
| BESIM LIMON GACI | 11 |
| LIRETE HYSEN KADA | 11 |
| SKENDER MAKSUT MURATI, | |
| ROBERT SKENDER MURATI | 11 |
| DURIM HALIM PERGJEGJI | 11 |
| VERA BRAHIM DEMUSHI, | |
| EMIRSON RASIM DEMUSHI | 11 |
| XHEVAHIR DED MARASHI, | |
| DED CUN MARASHI | 11 |
| RAMAZAN HAMIT MATRISI | 11 |
| PERPARIM FADIL XHAFERI | 11 |
| HYSNI JONUS XHAFA | 11 |
| ANTON NDUE BRACI | 11 |
| KASEM OSMAN UZUNI | 11 |
| XHAFERR QAZIM FILOLLI, | |
| QAZIM XHAFERR FILOLLI | 11 |
| FEMI AVDI HYSENAJ,BEHARE | |
| QAZIM HYSENAJ,ERIKSON | |
| FEMI HYSENAJ | 11 |
| SELADIN QAZIM IMERAJ, | |
| MYRTEZA QAZIM IMERAJ | 11 |
| GJELOSH PREL ALIAJ | 11 |
| LAVDIE HAMIT DAMZI + BP | 11 |
| MARASH MHILL IMERAJ | 11 |
| NAPOLON RESUL ABAZAJ | 11 |
| AGRON MIRASH BOSETA | 11 |
| SHYQYRI HAMDI VATA, LUAN | |
| HAMDI VATA | 11 |
| NAZMI SHABAN HYSA | 11 |
| MUHARREM TEME BRAHIMI, | |
| ALFRED MUHARREM BRAHIMI, | |
| FLORJAN MUHARREM BRAHIMI | 11 |

MEXHIT MUHARREM LIPO 11
ASTRIT FAZLI BRATI, RIFAT
HALIL BRATI 11
ARTAN GJON QOKAJ 11
ZYHDI FAIK HYSA 11
DORJAN SELMAN BENGU 11
ZENEL FETAH IBRA, ENGJELL
ZENEL IBRA, VULLNET ZENEL
IBRA 11
XHEMAL HAJREDIN SHEHI,
MIHANE AQIF KOLIÇI 11
HAKIK HAKIK SHOUTI, ASLLAN
HAKIK SHOUTI +BP 11
PETRIT VELI NAZO 11
GJERGJ JAK DODA 11
ALBERT HASAN DUCKE 11
MARASH KOLE QOKAJ 11
VALIDE HAXHI RUCI 11
MARINGLEN IRFAN METELLARI 11
SAFET MURAT HOXHALLARI 11
QAZIM ZENEL ZELA 11
MALIQ LIVAN KLLOGJERI 11
GRAMOS ASLLAN LLAPO 11
BILBIL MYFTAR LLAPANJI 11
BESNIK AVDIL PACI 11
TODI PALE NDONI 11
VERIE CAUSH LLAPO 11
HAJREDIN BAJRAM
CAUSHAJ + BP 11
ROZETA RAMADAN
SHKEMBI + BP 11
BUJAR GANI ZENELI 11
PERPARIM REFAT ZANI 11
QAZIM ZYBER BELBA 2
BARDHYL SELIM ABAZI 2
QEMAL ALUSH KARAJ 2
ZERE RAMIS KERKAPI 2
GEZIM RIZA SALIU 2
SEFE JAKUP ALLARAJ 2
HEKURANE SABRI KOCI 2
HAQIF NEZIR LITA 2
XHEVDET ALI BALI 2
FIQIRET TASIM MURATAJ 2
BILBIL MUSTAF ALIAJ 2
BRUNILDA RAMADAN KULLOJKA2
ELIDA MARK DOCI ARBEN TONIN
DOCI EVA TONIN DOCI 2
DASHNOR BAKI TOCILLA 2
MEVLAN SHAQIR BETI 2
ET-HEM QAZIM KOCI 2
DASHNOR BAKI TOCILLA 2
SOKOL SADIK HOXHA 2
DEVIS SHABAN HASTOCI
OLTIAN SHABAN HASTOCI 2
BEDRO TARE LICAJ 2
MEHMET ABDULLA TOCILLA,
FEJZI MEHMET TOCILLA 2
AFRIM ALI SHEHU 2
BESNIK QAZIM MARGJEKA,
EDUART QAZIM MARGJEKA 2
FLAMUR KADRI CANI 2
RIZA XHEMAL BIBA 2
PERPARIM RIZA CANI RIZA
SELIM CANI 2
FATJON SHEFQET XHABAFTI
HATIXHE MUHARREM
XHABAFTI 2
AQIF SINAN XHAFA 2
RRAPUSH AHMET LENA 2
ARDIAN BESIM HYSA 2
FERDINAND HAMIT KATESHI 2
SPARTAK XHELAL MARKU 2
BEDRO TARE LICAJ 2
AVNI ALI AGOLLI 2
ANDRI VESEL VASKU 2
XHEMAL,LULZIM NEVRUZ
HASKASA 2
AGIM MALIQ TOTA 2
DITAR HYSEN BILALI 2
ABAZ HYSEN GJANA 2
RIFAT RAMIZ KODRA 2
IBRAHIM MAHMUT KOSTA 2
AGRON AQIF XHAFA 2
NIKOLL ZEF GJONAJ 2
DITAR HYSEN BILALI 2
ABAZ HYSEN GJANA 2
HAJRULLA SALI KRENA 2
FATMIR RAMAZAN HAKCANI 2
SHEFIK REFIK OCKA 3
RAMAZAN SYRJA HOXHA 3
ERMIRA MARK GJERGJI 3
FATMIR HASAN SINANI 3
MEHMET ISLAM NURI,QEFSERE
DEMIR NURI SAIMIR MEHMET
NURI,GENTIAN MEHMET NURI 3
ARDIAN HYSNI KALLUSHI,
SAIMIR HYSNI KALLUSHI 3
ARTAN YLLI BYLYKBASHI
YLLI DEMIRAL BYLYKBASHI 3
EDMOND ADRIATIK ABAZI,
ADRIATIK HYSEN ABAZI 3
ILIRJAN HASAN SINANI 3
HYSEN SELIM KOKONOZI 3
ZARIF HYMET MUCOLLARI 3
PAL EDUARD PATRIK PALUSHI 3
FATJON LUAN TARE 3
PRANVERA FISNIK DODO 3
LUIZA PANDI KOLASI 3
MYLAZIM MUSTAFA KUBURI,
SPAHI MUSTAFA KUBURI 3

SHERAF HAMET BESHIRI,
SHANIKO HYSEN BESHIRI 3
XHEVAIR AHMET ALTERZIU 3
FATMIR DULE DANI 3
ASLLAN SINAN BOGDANI 3
QAMIL MALUSH NELI 3
JORGJI PETRO JANOLLARI 3
ULVO AXHEM BULAJ FJORELA
IDAJET BULLAJ ENI IDAJET
BULLAJ ALDO IDAJET BULLAJ 3
SILVANA SAMI MESTANI 3
JETNOR SHERIF NELI 3
EDMOND AHMET KODRA
VASIL AHMET KODRA 3
VANGJEL SOTIR SHTEMBARI 3
MERSIN SALI DOKA 3
HALIL MUSTAFA HOXHA 3
SHAQIR QAZIM MUCA 3
BARDHYL SHYQYRI MOLLANJI3
HYQMET FERIT CUKA 3
AGRON SHAHIN BARAMAJ 3
LULZIM XHEMAL HOXHA 3
MIRDASH AVNI DEMIRAJ 3
MEDI HALIL KURTI, SAMI
HALIL KURTI 3
NJAZI NEIM ORHANI 3
AGIM QAMIL IBRA 3
IBRAHIM BAJRAM GOGA 3
PELLUMB KAMBER SATERI 3
FATBARDH XHEMAL HOXHA 3
GJON MUSE QEHAJA + BP 3
HASAN QAZIM STOLJA 3
AGIM HASAN RAMALIU 3
FIQIRIJE RAMUSH KORIMANI,
LUFTIM SELAMI KORIMANI 4
SULEJMAN BEQIR BALLIU 4
AHMET HASAN SHKEMBI 4
PELLUMB RAMADAN OSHAFI 4
KUJTIM DERVISH MUSI 4
DYLBERE NUREDIN SULA 4
BUJAR MERSIN NEZIRI 4
TEFIK SKENDER LIÇO 4
FADIL ALI LIKA 4
DEMIR QAMIL KRUSA 4
DRANE ZEF GJINI 4
ÇLIRIM NEXHIP HALILI 4
HAJRULLA HAMIT MUÇA 4
GANI DERVISH MUSI 4
ELIDON ABDI SULA 4
TAHIR LULASH GJOKLAJ,PREK
LULASH GJOKLAJ 4
ALEKSANDER ZEF MURRI 4
LIMAN LIMAN TOSKU 4
HAXHI MAHMUT LICA,FITIM
MAHMUT LICA,SHYQYRI
MAHMUT LICA 4
LAZIM QAMIL KRUSA 4
ESMA ALIM HAMZAJ 4
DED MHILL THANA 4
ISMAIL HASAN MANREKA 4
BEDRI XHAFER VEIZI 4
SABRI ISMAIL VISHKURTI 4
FESTIM DYLEJMAN HOXHA 4
BAHRI AHMET BEQIRAJ 4
PREND ZEF MEMAJ 4
ZEFIRE TAHIRI,KLODIAN
SKENDER TAHIRI 4
SAIMIR HIQMET XHAMBAZI 4
RAMAZAN SELAMI KARIMANI 4
AGRON HILMI SHERIFI 4
NDOKE SOKOL KOLENDREU 4
SHABAN SULEJMAN ALLUSHI 4
AGRON XHEVIT DULAJ 4
RESHIT LIMAN SALA 4
DILAVER BATO BASTRI 4
MISIR ISMAIL MAXHAKU 4
BASHKIM VELI ISAKU 4
ZENEL BILAL LAMA 4
BLEDJAN TOLE ARAPI 4
LAVDERIM XHEMAL CENA 4
FERJAT SEFEDIN DALLIU 4
RRAHMAN DEM BARDHOSHI 4
SULEJMAN XHELADIN KOLECI 4
FRAN SOKOL RAMAJ 4
MAHIR BAJRAM RAMA 4
QEMAL JAKUP TARJA 4
AJDIN ILJAS MUCA 4
EUGEN KRISTO KODRA,
SELAMI REMZI KODRA 4
ALBAN PETRIT BEKA 4
DIN RRUSTEM ISMAILAJ 4
UZRI AMZA HAMZAI 4
KUJTIM ISUF KOKA 4
SHABAN ISLAM SMALAJ 4
SABRI BAJRAM LLUAKJ 4
NIMET EMIN QEMALI 4
RAM MEHMET AHMETAJ 4
ZENEL ABEDIN XHAMBAZI 4
REXHEP SADUSH LIÇI 4
ILIR REXHEP HABIBASI,PAJTIM
REXHEP HABIBASI 4
BEQIR QAMIL LIKA 4
RAMADAN BESIM RAMA 4
BILAL HAMIT ÇUNI 4
PETRIT BAJRAM KECI 4
ASTRIT ABDI GJAPI 4
PETRIT OSMAN BEQIRI 4
GJON NIKOLL MALETAJ 4
MEHDI SHEFQET
KARABRAHIMI 4

EDMOND ABDI SULA 4
JEMIN ASLLAN LIMANI 4
BYLBYL PAL MEMA 4
FATMIR IZET QERIMI 4
PJETER ZEF VATAJ 4
LIRI ZYBER BEKA 4
MINA NAIM SHTEMBARI 4
XHEMIL VEPRON FERATI,NURI
VEPRON FERATI 4
ILIR HAZIZ XHAMBAZI HAZIZ
ABEDIN XHAMBAZI 4
SHKELQIM RIZA TILA FAHRI
DILAVER RAMA 4
GJERGJ KOLE QAVEZA 4
GUXIMTAR FAIK MATJANI
FATMIR FAIK MATJANI 4
PELLUMB ZEF QOKAJ 4
AGRON DEMIR DEMIRI 4
ISLAM YMER DISHA HANKE
YMER DOMI 4
SHPETIM ABDULLA MURATI 4
SHANIKE SALI HYSENI 4
GEZIM HASAN STAFA ALI
ASLLAN HALILI 4
ILIR SHEFQET SHEHAJ 4
VLADIMIR FIQIRI DAMZI 4
AGRON SHYQYRI BANI 4
DAUT RAMADAN BARDHI,
KUJTIM DAUT BARDHI 4
REFIK DERVISH BRUCI 4
HAMDI SELAMI KARIMANI 4
RUSTEM DYLEJMAN HOXHA 4
GJELOSH NDOKE SUSAJ 4
MUHARREM REXHEP GANI 4
HAJDAR MALIQ HIDA 4
BESIM LIMAN SALA 4
FANOL FERAT DUMANI 4
VEBI DERVISH BRUCI 4
SHQYQRI HAJDAR BEKA 4
FRAN MHILL BUSHGJOKAJ 4
ILIR MUNIR UKA 4
GANI MUSTAFA HYSA,IRAKLI
MUSTAFA HYKA 4
KADRI BAJRAM GJUZI 4
JASHAR DALIP KACI 4
XHEMAL HAJDAR KACOLLJA 4
ELJON MALIQ HAJDARI,GJURI
RAMADAN POLICI 4
ZHUJE SHERIF NEZAJ 4
SULEJMAN HAMID BANI 4
GEZIM HASHIM DELIU 4
EDUARD GJIN GJONAJ 4
XHEVAT ISLAM ISMALAJ 4
BUKURIE DESTAN MANCILA
HEKURAN SEFEDIN MANCILA 4
QAMIL MUHARREM MANI 4
SHKELQIM HYSMET KAZANI 4
SOKOL ZEF VATAJ 4
DYLBER ZEJNI YMERI 4
FATMIR HEBIP EBIP 4
NDUE MARK LLESHI 4
AGIM SULEJMAN KRUJA 4
SHKELQIM KADRI GJUZI 4
LORETA KADRI BEGANI 4
ARBEN ABDULLA MUCA 4
EMIN OSMAN KACANI 4
LORETA KADRI BEGANI 4
SINAN SEIT KAZANI 4
ILIA SOTIR LEKA LATIF
RIZVAN ABRASHI 4
AHMET SABRI POPSHINI 4
ARBEN MYSLYM DURISHTI 4
MUSA MEXHITKABILI 4
DALIP HYSEN RAMA 4
FERIT AHMET NDREGJONI 4
FATMIR SEFEDIN XHAMBAZI
SEFEDIN QAMIL XHAMBAZI 4
PETRIT JONUZ MEMA 4
ILIR ASLLAN MUCEKU 4
FESTIM VASFI META 4

DRITAN SKENDER ALLUSHI 4
ZAMIR ALI BARDHI 4
HASAN ABDYL RECI 4
FABJAN PREND GJONAJ
PREND NIKOLL GJONAJ
KUJTIM NIKOLL GJONAJ 4
HAN IBRAHIM NDREKA 4
DIANA HETEM HASANI
ELTION HASIM HASANI
BLERAND HASIM HASANI 4
BRAHIM ISLAM PROZLLAMI 4
FITIM SHEFQET ISLAMI 4
MIFTAR XHEMAL TOTA 4
FLUTURA RAMAZAN RUSHITI
SKENDER ISMAIL MEHMETI 4
HASAN HAXHI AFMATAJ 4
PREL MARK VUKSANI 4
ZEF MIRUSH PREKAJ 4
MEDI AGIM KACA 4
HAKI BAJRAM GJUZI 4
XHETAN NAZIF LUMI 4
KUJTIM PAL MEMAJ 4
MARASH PAL PROGNI 4
MAN OSMAN SHIMA 4
GJOVALIN BIBE ARAPI,
ROLAND ALBAN SHKELQIM
GJOVALIN ARAPI 4
LUMTURIJE MEXHIT KABILI 4
XHETAN NAZIF LUMI 4

KUJTIM PAL MEMAJ 4
ABDULLA HYSEN KRASNIQI 4
NAZMI DEMIR TOCI 4
DRITAN LUSH HASVATA 4
PLLUM NIKOLL DEDNDREAJ 4
KLODIAN XHAVIT KOTORI 4
NAIM AVDULLA MEMAJ,
ALFRED ABDULLA MEMAJ 4
SKENDER DILAVER BALLA 4
BAJRAM QAZIM HYSA 4
ALFRED BAFTJAR XHUTI 4
HYSEN IBRAHIM SALKU 4
HALIT RIZA NAZMI SHABAN
MECI 4
ARTAN MALIQ SPAHO 4
IDRIZ RAMADAN KRASNIQI 4
ZABIT BAJRAM KOLA
SHKELZEN ZABIT KOLA 4
VATH HYSEN TAFAJ 4
NAIM SALIH TETA 4
MYSLYM IBRAHIM MURATI,
SABRI IBRAHIM MURATI 4
BUJAR DILAVER BALLA 4
DHIMITER KRISTI CILI 4
ABEDIN MALIQ TARJA 4
BASHKIM REXHEP TARJA 4
OSMAN HAXHI HAJA 4
LULZIM HAKI KACI 4
GJON ZEF CERA,ALBERT GJON
CERA,PAULIN GJON CERA 4
QAMILE DEHAR ALIHYSENAJ,
DONIKA SULKEJMAN
(ALIHYSENAJ) UKA 4
ELTON ENVER ZGENA 4
RAMADAN YMER DISHA 4
RAMAZAN IBRAHIM AVDIU,
MEDI IBRAHIM AVDIU 4
SHPETIM SHEFQET
KARABRAHIMI, JASHAR
SHEFQET KARABRAHIMI 4
PETRAQ LLAQI BUZO 4
LUAN BAJRAM LIKA 4
HASAN ZANO KUCI 4
EDMOND SINAN TRESA 4
MEHMET SULEJMAN CENI 4
JUSUF DALIP MURATI 4
BASHKIM ABAZ ZHABOLI 4
ISLAM NAZIF LUMI, RRUZHDI
NAZIF LUMI 4
YLBER ELEZ METALLARI 4
YLBER AQIF XHAFERI 4
MINE HASAN MUCO 4
HAZIS HASAN DEVA 4
LUAN EQVER ZYFERI 6
LUAN EQVER ZYFERI 6
SAIMIR IDAJET KOBUZI 6
ADMIRIM ZIJA KORANCE 6
MUHAMET DAUT HAJDARAJ 6
RUKIJE CEN LAMA 6
ZALO HYSNI CELA TURHAN
SELAM CELA 6
KADRI NASIBI HOXHA 6
SHKELZEN XHEMALI SHUPLI 6
ALBAN LAZAN KOLDASHI 6
FITIM HAMDI KATESHI 6
BUJAR DEMIR HAJDARI 6
ARTAN BELUL ISUFI 6
GAZMEND XHEMALI SHUPLI 6
SADIK DALIP LUMI 5
REFAT ABDI BALLA 6
KLAUDIO KASTRIOT
HYSENBELLI 6
FEHMI KUJTIM GJANA 6
VENDIM DAUT HAJDARI 6
SOKOL VAZIM COLLAKU 6
NAIMBESIM BILALI 6
SHPETIM SHEFQET SAHITAJ 6
XHEVDET ALI MUCA 6
EDMOND CELNIK PRENJASI 6
ÇLIRIM BARI ADILAJ 6
ALI HAXHI XHEPA 6
SELIM MUSE RROGAMI 6
JANI SAFET PASHO 6
SHPETIM FASLI CELIKU 6
LIRIJE SHERIF PERA 6
PETRIT IBRAHIM GJOSHI,
XHAVIT IBRAHIM GJOSHI 6
FATMIR VESEL LLENGA 6
BEDRI ELEZ KOLA 7
NIKO MYFIT TOPI 7
KUJTIM IBRAHIM CACA 7
SELIM SHEFQET GJANA 7
FAIK ISLAM ISLAMI 7
HANEME REFAT MECE 7
ISLAM XHEFERR HOXHA 7
BUJAR TASIM MATA 7
KOL DED POPAJ 7
SHEFKI ELMAZ SULI 7
DRITA QERIM MUHARREMI 7
GENCI JANI CIKO,THODHORA
LLAZO CIKO 7
HASAN BAJRAM BASHA
( KOPJA E HIPOTEKES) 7
TEREZE MARK NIKOLLI 7
RAHIME SHERIF SHALCA 7
RAMAZAN RAMADAN
TERSHALLA 7
OLSI RAPO KLLEPKA 7
ARDIAN QAMIL GJONI 7

TEFTA SYRI RAPO 7
LIMAN HAZIZ KOKA 7
ILIA ALI KOCA 7
BUJAR SELAMI BREGU 7
FIDANE REXHEP DUKA 7
SAFET GURALI HOXHALLARI 7
RAHIM RAMADAN ZILI 7
KRESHNIK HALIT KUKELI,
HALIT MUSA KUKELI 7
PASHE ISMAIL AGO + BP 7
NIKOLIN FERIT ALLIU 7
KIN NDOC GJONPALI 7
ISLAM MUSTAFA HALLVAXHIU7
SHAQIR SELMAN MURATI 7
SEFEDIN FEHIM MERO 7
ERVIN ABAZ DUSHKU 7
ANASTAS XHEMIL ZACE,
EDISON XHEMIL ZACE 7
VALTER SEFEDIN MERO 7
PETREF NEHAT TOPI 7
ANDON JOSUF NIKA 8
DALIP XHEP GJANA 8
BESNIK RIZVAN KARANXHA 8
ENGJELL MUHEDIN SHEHU 8
DRITAN HYSNI KOCI 8
FESTIM ALI ALLARAJ,FATIME
RIZA ALLARAJ 8
DELI PJETER SHEQERI 8
KRISTIAN DEDE MULAJ 8
KOLE TONE SHKAMBI,
EMIRANE KOLE SHKAMBI 8
NEZIR SELMAN CANAMETI 8
DASHAMIR NUREDIN SEJDINI 8
HAXHI GANI HALILAJ 8
SADIK IBRAHIMI LOKA
FATOS SADIK LOKA 8
ASTRIT NAZIF ZEMBLAKU 8
PASHK JAKU CUNI YLLI
PASHK CUNI 8
KASTRIOT SELIM DODA
DHURATA KASEM DODA 8
ISLAM ILJAZ RUDAKU 8
KUJTIM NAZIF ZEMBLAKU 8
DED IBRAHIM STEAJ 8
FLAMUR KADRI CANI 8
SADIK LLAN PECA BAJRAM
SEJDI MARKAJ 8
FEJZO SULO LAMA 8
ARBEN REXHEP SHULI 8
BASHKIM OSMAN
MEHMETAJ NAIM OSMAN
MEHMETAJ 8
LATIF SALI KAZANI 8
BEKIM XHELAL MURJA
JAHJE XHELADIN MURJA
MEHMET XHELADIN MURJA 8
HEKURAN IBRAHIM SELISHTA8
ANDREA NEXHIP NANO,
AFERDITA SAFET KREKA 8
ZEF GJIN
MARKU, NDUE,MARK,KOL,
ARBEN ZEF MARKU 8
AGIM NIJAS BASHILLARI 8
LUAN SKENDER XHAMBAZI 8
SHEFQET SOKOL LUSHAJ 8
AGIM NIJAS BASHLLARI 8
LUAN SKENDER XHAMBAZI 8
MYFIT RAMADAN LALAJ 8
SHEFQET SOKOL LUSHAJ 8
ASTRIT REXHEP LIKSALA + BP 8
ZIHNI ALI MILA 8
PETRIT SHYQYRI THOMARAJ 8
RROK LULASH UKA 8
ASTRIT RAKIP OSMANI 8
ARDJAN ENVER LOCA 8
JANI RAMIS HAJDARI 8
TON MARK PJETRI 8
GJELINE PJETER BUCI 8
DEDE NDUE MISHAJ 8
KUJTIM MARK ALIA,
GJIN MARK MARKU 8
TONIN DED NDOU 8
MARK DED NDOU 8
NEXHMIJE SADIK ORUCI 8
ALBAN HYSNI HYSA 8
FEHMI XHELADIN SUTI 8
ZEJDI ELEZ KOPSHTI 8
MARTIN PRELE DEDAJ 8
ARBEN NEZHDET TEROLLI 9
HYSNI IDRIZ ISUFAJ 9
VASFI SHERIF GJONI 9
MIRJAM NUSRET ALI 9
ARSHI MALIQ BARDHI 9
ALI RAMIZ QINANI 9
ILIR SADIK TUSHA 9
REFAT SELMAN ALLA 9
BAJRAM XHAVIT KALECI 9
MESAR CAUSH SINAMETA 9
IBRAHIM ABDI HOXHA 9
ILMI JASHAR HOXHA 9
SHEFKI SEXHADIN SHKEMBI 9
BASHKIM AZIS NDREKA 9
VANGJEL DILAVER NUHO 9
FILE ADEM CANI 9
LUTFI XHEMAL DURISHTI
ZYHRA XHEMAL DURISHTI 9
ADRIATIK RUFAT CENAJ 9
MYRVETE TAHIR MERA 9
JANI ISMAIL ZHUZHI 9

AVNI XHAFER JANGULLI 9
BASHKIM QAZIM MUJA 9
XHEMALI MEXHIT KOLTRAKA
XHIBE TAHIR KOLTRAKA 9
QEMAL ARTUR HEKTOR ALMA
ANA OTT DRITE SHIQERUKA 9
NAZIF HIME KADRIU 9
ELHAM HAQIF ZHUZHI 9
SAMI DALI SULA 9
PETRIT NEXHIP LIKO 9
KLEMENT SINAN RRAHMANI,
FIGALIA NIKOLLA RRAHMANI 9
FATOS BASHKIM MIRA 9
LEONORA BAJZIT RECI
XHESMINA FATOS RECI EMIR
FATOS RECI 9
JETMIR MEXHIT YZO 9
SHEFKI JONUZ TAFA 9
ALUSH ILJAS ZIRA 9
SHEFIK ULVI CAUSHI 9
NEXHMI HAMZI HYSA 9
RAMIZ GAFUR HASA URIM
RRAMIZ HASA 9
ENVER SEFEDIN DAUTI
SHKELQIM SEFEDIN DAUTI 9
ASLLAN SULEJMAN LOCA 9
SHERIF HAXHI HAJDARI 9

SHEFQET XHEMAL ALIMADHI 9
NAZMI FASLI DURAKU 9
GENCI HAXHI PICI,LOZJANA
HAXHI GJIZA 9
SOKOL PETRIT ALIAJ 9
ARDJAN PETRIT ALIU 9
NAZMI MUHARREM KIKA 9
ZAIM VESEL GAZIDEDE 9
ZEQIR SULEJMAN BARDHI
+BP 9
ILIR SALI ISMAILI 9
HASAN RAMADAN DOKA 9
ROBERT AQIF BICI 9
SURJA RUSHIT DERNOVA 9
FARI NEBI DRAGJOSHI 9
ISUF HALIT MULDAKAJ 9
BAJRAM MUHARREM META 11
CELNIK HAMZA HAZIZI 11
SHABAN QEMAL CANO 11
IBRAHIM SELIM HALA 11
ASTRIT FAIK CERMA 11
MARK LUSH STEAJ 11
ILIA JAK NDREPEPAJ 11
RAKIP GANI ALLA 11
BESNIK TAHIR FILJA 11
NIKOLL NDREC LLESHI 11
REFAT IZET CAMI,FLORIAN
REFAT CAMI 11
SAMI GANI MURATI 11
DERVISH HAXHI DOCI,XHELAL
DERVISH DOCI 11
SELMAN AJAZ ISTREFI 11
RAMIZ ADEM XEKA 11
BAFTJAR HASAN MUSABELLIU 11
ARBEN PELLAN MOLLANJI 11
PERPARIM ISMAIL CEJKU 11
HAJRI AHMET MUCA 11
PETRIT LEKE HASAJ 11
AISHE ISUF LACI,DRITERO
XHEMAL LACI,SOKOL XHEMAL
LACI,ALTIN XHEMAL LACI 11
BESNIK ISUF LUSHNJA 11
ELTON AGIM KALECI 11
LAVDURIM XHEMAL CAMI 11
BASHKIM HASAN SITA,
NAZMI HASAN SITA 11
ARBEN BEXHET MEKA 11
ELMAZ SHABAN SULA 11
NAIM ZYBER MANREKA 11
AGIM PAL PEPKOLAJ 11
VESEL HAXHI IMERI 11
FATIME IDRIZ CANO 11
HAMDI SINAN META 11
HAMIT ALI BRUCI 11
MUSTAFA RESHIT LACI 11
REFIK MEXHIT SORRA 11
NAZMI HATE HASANLLARI 11
DEDE ZEF GECAJ 11
ARBEN REXHEP BUSHI,REXHEP
FASLI BUSHI 11
AGRON VEHAP XHEKA 11
LAZER KOLE QEHAJA 11
XHEMILE XHAFERR LEKA 11
VIKTOR PAL DELIA,ARTAN LEK
NDREKAJ,PJERIN PAL DELIA,
LULJETA LEKE DELIA 11
DRITAN HALIM ZHLLIMA 11
MERE MURSEL MUSTAFAJ 11
GJEVALIN MARK BUSHGJOKAJ 11
LUAN FERIT XHEJA,MIRELA
IBRAHIM XHEJA 11
BARDHOK PAL BUCAJ,MARK
PAL BUCAJ 11
SHYQYRI BAJRAM KADRIA 11
MEZARKO ALI AVXHI 11
SULI RIZA SHKEMBI,FATJON
ADEM MERO 11
ZIADIN SINAN SPAHIU 11
HASAN GANI PIRA 11
VATE CUN PREKPERAJ 11
LEZE PAL UKCENAJ,GEZIM PAL

UKCENAJ 11
SIMON DEDE GECAJ 11
BIBE CUN GECAJ CUN KOL
GECAJ 11
ASTRIT NDOC NDRECPECAJ 11
HAMET SAFE HASANLLARI 11
DOD PRENG JAKU 11
BEXHET NURI CAMI 11
BENIZ FRAN DODA 11
RROK TOM CARDAKU 11
FATMIR SHABAN PAJTONI 11
FLAMUR BIDO LLAPUSHI 11
ABAZ ZYBER MANREKA 11
BASHKIM GANI DUKA GANI
SHABAN DUKA 11
SULEJMAN HET MURATI ILIR
HET MURATI 11
ZYBER ABAZ MANREKA
SHPETIM ZYBER MANREKA
DONIKA SKENDER MANREKA 11
XHEMAL OSMAN SULA 11
RAZIM HAZIS META 11
LIMAN HALIL GJOKA 11
MEHMET BESNIK KULEMANI 11
XHEMAL ALI HIDA 11
FATOS HALIM LILA 11
AMIR ALI PEPOSHI 11
SHYQYRIE BESHIR MARKU 11
ISLAM MYSLIM HAKCANI 11
PASHK UKE ALIA 11
ENVER STAF PERHALI 11
ALBERT QANI KAJA 11
ENVER KAMBER SALLAHI 11
SKENRDINAND QANI KAJA 11
IBRAHIM RAMAZAN LIKZELIA 11
KADIFE ALI HAKA 11
XHEMAL SHERIF TROCI 11
IDAET NURI SHUKULLI 11
DED LULASH NIMANI 11
ISMAIL RIZA SHEHI,LUAN I
SMAIL SHEHI 11
RUSHIT FADIL ELEZI 11
QOSE 11
NAIM ALI SINA 11
GJELOSH KOKER PREBIBAJ 11
REFIK BEQIR HOXHA 11
RAMIZ XHEMAL LUSHNJA,
SAJMIR RAMIZ LUSHNJA 11
BISLIM AZEM AJDINI 11
DRITAN FIQIRI BUSHI 11
ISTREF SELAM DOMI 11
ISMET MUHARREM ZISKO 11
XHAFER AHMET MULGECI,CAN
AHMET MULGECI 11
AMIR SINAN SPAHIU 11
KOL GJERGJ QUNI 11
PERPARIM SHERIF BULKU 11
ZYHDI ZENEL SIPRI 11
NAIM XHEMAL RRASA 11
XHAVIT RIFAT SUFAJ,ARBEN
XHAVIT RECI,LAURENT XHAVIT
SUFAJ 11
PJETER MHILL ALIJA,
PASHUK PJETER ALIJA,
GJOVALIN PJETER ALIJA
FERIT PJETER ALIJA 11
BEGLIE RIZA BATALI 11
RASIM IBRAHIM MEHIDRI,
IBRAHIM ALI MEHIDRI 11
REXHEP HASAN SHEHU 11
LEKE MARTIN LEPEJA 11
RAMAZAN XHEVDET BOSHKU 11
FERIT XHEMAL ZHUZHI 11
HASHIM MAN DRAGJOSHI 11
TEUFIK RIZA COLLAKU 11
ARJAN GJOKE RRAHI 11
SELMAN RIZA TANUSHI,
SHAHE LIMAN TANUSHI 11
NIKO MYSLIM VILA 11
IBRAHIM MURAT KUNXHIU 11
RUTE KOL KACI,XHEVAIR
ESAT KACI,GENTIAN ESAT
KACI,ENGEL ESAT KACI 11
MURAT AVDI FIDA 11
DRITA JONUZ RAMA 11
ENVER ISLAM MISKU 11
ROMEO DANIELA HODO,
AFERDITA HODO 11
ILIR SHEFQET SHEHAJ 11
GJON LLESH DOCI 11
PASHK LUSH MARKU 11
ALI FAIK RAMA 11
ENGJELL AVNI MATA 11
PREKE PALI PERPELAJ 11
KADRI FUAT ALUSHI 11
ZAIM HYSEN VESELI 11
FERIT SHAQIR BOSHKU 11
ILMI MURAT BOSHKU 11
ALLAMAN IBRAHIM DOKU
MENTORALLAMAN DOKU
FESTIM ALLAMAN DOKU 11
PJETER GJOK DEMAJ 11
LUAN ABAZ SHEHU 11
SHKELQIM IBRAHIM GJOKA 11
ARJAN QAMIL SEJDINI 11
HAMZA SABRI LILA 11
MIMOZA ENVER ZYBERAJ 11
RUSTEM SELMAN RRUSHI 11
FATMIR SALI PLAKU RUDINA

SEJDIN PLAKU 11
HALIM SHABAN BRIJA 11
ALBAN XHAFER BALLA
DEZDEMONA GJIN BALLA 11
FATMIR MARK SUSAJ 11
LULEZIME NEZIR DURA 11
MARK ZEF VUKZA 11
ARBEN HAXHI SULAJ
ARDIAN HAXHI SULAJ 11
PERPARIM VEHAP XHEKA 11
MOJSI OSMAN TURJAN 11
ILIR MEHDI HYSA 11
PETRIT RAMADAN SHERIFI 11
XHEVDET RAMADAN CANE 11
BESIM RUSTEM MANSAKU
ASTRIT BESIM MANSAKU
SARARUSTEM MANSAKU
RENATA XHEVDET MANSAKU
MARIGLEN RUSTEM MANSAKU 11
SH 11
KUJTIM MULI BASHA, EDIP
MULI BASHA 11
GJOVALIN PJETER QOKAJ 11
ASTRIT HAMDI PUCI 11
FAIK DEMIR BLUSHI 11
YLLI ENVER PRAPA 11
SERVETE MUHAMET BENGO 11
KLODIAN HYSNI TAKACI 11
KRISTAQ BEQIR VOGLI 11
ISMAIL GANI LALA 11
ALTIN BAJRAM PULA 11
NAZMI HAMDI SUKITHI 11
FAIK DEMIR BLUSHI 11
YLLI ENVER PRAPA 11
SERVETE MUHAMET BENGO 11
ALI SHABAN MADANI 11
SHYQYRI OSMAN DEMA 11
ANESTI HAKIL ZGURO,
JETNOR ANESTI ZGURO 11
ESAT RAHMAN KURTEJ 11
ALI BIB FIRI 11
MURAT XHELADIN BEQIRI 11
GEZIM SUL DEMA 11
BESIM LIMON GACI 11
LIRETE HYSEN KADA 11
SKENDER MAKSUT MURATI,
ROBERT SKENDER MURATI 11
DURIM HALIM PERGJEGJI 11
VERA BRAHIM DEMUSHI,
EMIRSON RASIM DEMUSHI 11
XHEVAHIR DED MARASHI,
DED CUN MARASHI 11
RAMAZAN HAMIT MATRISI 11
PERPARIM FADIL XHAFERI 11
HYSNI JONUS XHAFA 11
ANTON NDUE BRACI 11
KASEM OSMAN UZUNI 11
XHAFERR QAZIM FILOLLI,
QAZIM XHAFERR FILOLLI 11
FEMI AVDI HYSENAJ,BEHARE
QAZIM HYSENAJ,ERIKSON
FEMI HYSENAJ 11
SELADIN QAZIM IMERAJ,
MYRTEZA QAZIM IMERAJ 11
GJELOSH PREL ALIAJ 11
LAVDIE HAMIT DAMZI + BP 11
MARASH MHILL IMERAJ 11
NAPOLON RESUL ABAZAJ 11
AGRON MIRASH BOSETA 11
SHYQYRI HAMDI VATA,
LUAN HAMDI VATA 11
NAZMI SHABAN HYSA 11
MUHARREM TEME BRAHIMI,
ALFRED MUHARREM BRAHIMI,
FLORJAN MUHARREM BRAHIMI 11
MEXHIT MUHARREM LIPO 11
ASTRIT FAZLI BRATI, RIFAT
HALIL BRATI 11
ARTAN GJON QOKAJ 11
ZYHDI FAIK HYSA 11
DORJAN SELMAN BENGU 11
ZENEL FETAH IBRA, ENGJELL
ZENEL IBRA, VULLNET ZENEL
IBRA 11
XHEMAL HAJREDIN SHEHI,
MIHANE AQIF KOLIÇI 11
HAKIK HAKIK SHOUTI,
ASLLAN HAKIK SHOUTI +BP 11
PETRIT VELI NAZO 11
GJERGJ JAK DODA 11
ALBERT HASAN DUCKE 11
MARASH KOLE QOKAJ 11
VALIDE HAXHI RUCI 11
MARINGLEN IRFAN
METELLARI 11
SAFET MURAT HOXHALLARI 11
QAZIM ZENEL ZELA 11
MALIQ LIVAN KLLOGJERI 11
GRAMOS ASLLAN LLAPO 11
BILBIL MYFTAR LLAPANJI 11
BESNIK AVDIL PACI 11
TODI PALE NDONI 11
VERIE CAUSH LLAPO 11
HAJREDIN BAJRAM
CAUSHAJ + BP 11
ROZETA RAMADAN
SHKEMBI + BP 11
BUJAR GANI ZENELI 11
PERPARIM REFAT ZANI 11

BOTIMI

# Tefta Tashko Koço

## Këngët e padëgjuara dhe regjistrimet në Milano

Fatmira Nikolli

*Niko Kotherja ekspozon 3 disqe të reja, Eno Koço: Këngë të vitit 1942*



Portreti i ëmbël i saj, koka e mënjanuar poshtë, profili i majtë, një fustan i bardhë dhe duart sipër gjunjëve.

Një ekspozitë me materiale dokumentare dhe fotografike është çelur dje në Korçë për Tefta Tashko Koço me rastin e 71-vjetorit të ndarjes së saj nga jeta. Aktiviteti u mbajt në ambjentet e Muzeut Kombëtar të Arsimit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe".

Për herë të parë u publikuan gjashtë këngë të panjohura të saj. Prej dekadash ato qenë cilësuar të humbura nga fondi i dëshmive të saj zanore. Këngët ruheshin në tri disqe, të gjetura tetë vitet e fundit nga Niko Kotherja, pjesë e koleksionit personal të disqeve shqiptare.

Ekspozita e djeshme ekspozoi 21 disqe të regjistruara nga Tefta në vitet 1937 dhe 1942. Nga këto, tri me nga dy këngë, ishin materiale zanore, regjistrime të saj të panjohura me parë dhe që kishin mbetur të padëgjuara. Veç tyre, u ekspozuan edhe fotografi nga jeta e Teftës dhe familjareve të saj duke shfrytëzuar edhe fototekën e Studio "Sotiri" në Korçë, duke qenë se artistja ka pozuar për fotografin Kristaq Sotiri në mesin e viteve 30. Gjithçka që u ekspozua ishte origjinale, ndërsa gjatë aktivitetit u luajtën në gramafon tri disqet me 6 këngët e panjohura. Materialet muzikore qenë konsultuar më herët me djalin me Eno Koçon, djalin e artistes.

Këngët që u dëgjuan për herë të parë dhe që rezultonin ta humbura janë "Bilbil çapkën", "Shkapërceva dy tri male", "Ishin dy kunata", "Ku do shkosh moj goc e vogël", "Shamija e beqarit", "Dallëndyshe vaj, vaj", regjistruar në Milano me 1942 ne COLUMBIA.

Eno Koço, në pamundësi për të ardhur nga Britania e Madhe, dërgoi një letër, kur vlerësoi dhe çmoi së tepërmi gjestin fisnik të përkujtimit të nënës së tij. "Ju përkujtoni Teftën, rrënjët familjare të së cilës janë të lidhura fort me qytetin tuaj. U bënë më të forta e më të qëndrueshme këto rrënjë nga martesa e saj me Kristo Koçon, nga Boboshtica e Korçës. Tefta i kërkonte rrënjët e saj si në trashëgiminë familjare, në lidhjen me Kriston, por edhe në këngët tradicionale shqiptare që këndoi", shkruante Eno. Ai thoshte se ndjehej i privilegjuar që Niko Kotherja vazhdon të kërkojë e të gjejë këngë të padëgjuara më parë, të regjistruara prej Teftës në Milano më 1942. "I shoqi, që edhe ai regjistroi në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën shtëpi diskografike dy këngë, 'As aman o syr'i zi-e' dhe 'Seç këndon bilbili fushavet', ndihmoi së tepërmi të shoqen të regjistrojë 42 të tilla, nga të cilat 36 kanë qenë të njohura deri më sot. Dhe ja tani njohja me repertorin e saj zgjerohet. Nuk ka kënaqësi më të madhe për mua që, si bir i saj, të përjetoj njëkohësisht me ju këtë moment kaq domethënës. I ati i saj, Athanas Korçari, do të ishte krenar me të bijën për të mbajtur lart emrin e Korçës, ashtu si dhe unë, bir i saj, jam krenar me të dhe me babanë tim që e mbajtën frymën korçare gjallë gjatë tërë jetës së tyre të shkurtër",-vëren Eno Koço në letrën e dërguar për këtë rast. Sipas tij, kaligrafitë e shkrimeve të tyre aq karakteristike e personalizuese të pasqyruara në libërthin e shënimeve me këngë popullore që ata mbajtën midis viteve 1936-1945, të cilat i botova vitin e kaluar, janë një tregues më tepër i afshit të tyre patriotik kombëtar. Përveç librit dhe shkrimeve monumentale mbi Teftën të Dr. Pandi Bellos, tani edhe Nikoja plotëson jetën e saj me të tjera të dhëna, të cilat nuk i kemi njohur deri më sot.







E DIEL
30 Dhjetor
2018

MILOSAO

# MEAVE DE BURGH

## agjentja sekrete britanike që stërviste shqiptarët

NGA NDREK GJINI

Meave de Burgh jeton vitet e saj të pleqërisë në Wexford të Irlandës. Ajo është ndofta e vetmja grua, ende gjallë, që ka punuar si agjente në shërbimin e fshehtë anglez, gjatë kohës që ky shërbim stërviste të rinj nacionalistë shqiptarë në mërgim, me qëllimin për t'i dërguar me mision në Shqipëri për rrëzimin e regjimit komunist.

Në rrëfimin e saj për kanalin më prestigjioz publik të Irlandës, RTE1, Meave de Burgh tregoi rreth jetës së saj në Maltë, ku kishte punuar si shifrante në shërbimin e fshehtë anglez, ndërkohë që burri i saj Kolonel Charles Davison dhe kolegët e tij, stërvisnin të rinj nga mërgata shqiptare për t'i dërguar me mision në Shqipëri. Në këtë intervistë, ajo flet me mjaft respekt e simpati për këta të rinj, flet për ndjenjat e larta nacionaliste të tyre, për inteligjencën dhe përkushtimin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara, etj. Por sytë e saj mbushen me lot kur ajo sjell në memorie një natë tragjike ku humbën jetën gati 300 prej tyre, në një aksion që dështoi, për shkak të rrjedhjes së informacionit përmes dubël agjentit Kim Philby.

Meave u intervistua nga ky televizion për llogari të një emisioni mjaft të shikuar në Irlandë, të tituluar "Who Do You Think You Are?", emision që ka për qëllim të shpalosë para publikut irlandez rrënjët gjenealogjike të njerëzve të shquar. Ajo u intervistua si gjyshja e Rosana Davison, e cila pasi ka fituar Miss Bota disa vite më parë, tani është top-modelja më e bukur irlandeze.



Meave është e ëma e këngëtarit mjaft të mirënjohur të viteve '80-'90, Chris de Burgh. Ajo jeton vitet e pleqërisë së saj në këtë qytet të bukur turistik në lindje të Irlandës. Intervista e saj u konsiderua si një zbulim interesant përsa i përket jetës së saj në këtë mision të shërbimit sekret anglez si dhe simpatisë së lartë që ajo shprehu për këta të rinj shqiptarë.

Shtypi irlandez i kushtoi vëmendje për disa ditë radhazi deklaratave të saj rreth përpjekjeve të shërbimeve angleze dhe amerikane për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri si dhe tragjedisë njerëzore që shkaktoi roli i dubël-agjentit Kim Philby.

Një ditë pasi u dha ky program në RTE1, i cili përmbante dhe intervistën e saj, si gjyshe e Rosana Davison, një kolegu im profesor i gjenealogjisë, më takon dhe më dhuron një DVD. Ai e kishte regjistruar këtë emision. Ai më tha se këtë DVD ua kishte vënë në një orë leksioni ta shikonin edhe studentëve të tij dhe se kishin diskutuar gati dhjetë minuta rreth historisë së kësaj agjenteje dhe simpatisë së saj për Shqipërinë dhe shqiptarët. U ndjeva mirë, por disi konfuz. Kur shkova në shtëpi e vura atë DVD dhe e pashë sërish emisionin. Të nesërmen e futa në një zarf dhe ia dërgova një kanali televiziv në Tiranë, por nuk mora përgjigje.

Gjithsesi para disa muajsh u interesova prapë për fatin e Meave de Burgh. Mësova se ajo është ende gjallë.









Në këtë numër: NDREK GJINI, VISAR &EDA ZHITI, ROLAND GJOZA ETJ...

Redaktor: Ben Andoni. 368

K
KRIJIM

*Në vijim të ciklit të "Kastriotëve", Mark Ndoja shkroi në ishullin e Zvernecit në vitin 1967, tragjedinë në vargje që fillimisht mbante titullin "Vdekja e Skënderbeut" me temë betejën e fundit të heroit deri në fund të jetës. Tragjedia "Beteja e fundit e Skënderbeut", tragjedi me 5 Akte, rimerr personazhet e veprës "Kastriotët", që mbante nëntitullin: "Trilogji kreshnike". Me këtë dramë për Skënderbeun përmbyllet cikli i "Kastriotëve". Këtë tragjedi, autori e rikonceptoi pasi kishte shkruar Aktin I në Tiranë, por duke e vijuar në kushtet e rënda të internimit. Personazhet si Dodë e Gjin Perlati dhe nanë Mrica ruajnë karakteret e krijuara më parë në veprën "Kastriotët" sikundër Karaxha Beu dhe Ballaban Baderi i cili në pjesën III Reposh Kastrioti shfaqej asker i Serasqer Skënderbeut në Siri.*

# "KASTRIOTËT"



NGA STAFF "MILOSAO"

**ROMAN NË VARGJE**

Vepra Kastriotët, me 9000 vargje, është shkruar nga Mark Ndoja në vitet 1961-1964, në ndërkohën mes dy dënimeve; më 25 dhjetor 1964, kohë kur autori u internua për 5 vjet në ishullin e Zvernecit. Vepra botohet si porosi e autorit, që i kishte shkruar këto dy vepra në prag të kremtimit të 500 vjetorit të vdekjes së Skenderbeut më 1968, si lutje e miqve të tij poetë në vitet '90, si Pano Taçi e Vehbi Skenderi që kishin lexuar pjesë të dorëshkrimit Kastriotët, në vitet '60, sidomos për pasurinë e stilit poetik, narracionit të panjohur për Gjon Kastriotin dhe gjuhës epike-kalorsiake.

Libri u daktilografua nga bashkëshortja e autorit Milena, në vitet '90, dhe botohet si kushtim ndaj saj dhe autorit. Fragmentet e letrave të Markut dërguar së shoqes nga Zverneci japin një ide të skajshme për procesin krijues dhe itinerarin e kësaj vepre me travajet e jetës së autorit.

Vepra Kastriotët, është e shkruar me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skenderbeut dhe kishte nëntitullin Trilogji kreshnike, vepër në tri pjesë. Pjesa e tretë ishte projektuar për Gjergj Kastriotin, projekt që u modifikua në kushtet e reja të internimit në ishullin e Zvërnecit. Në vitin 1967, në vijim të ciklit të Kastriotëve, autori shkroi tragjedinë në vargje Lavdi e shekujve që fillimisht mbante titullin Vdekja e Skënderbeut, e cila do të botohet më vete.

Vepra Kastriotët përbëhet nga 9000 vargje me rima me masën 16 rr. dhe ndahet në tri pjesë sipas temave. Në pjesën e parë, Gjon Kastrioti përshkruhen luftërat e Gjon Kastrotit; në pjesën e dytë nis ekspedita kundër Gjergj Arjanitit; ndërsa argumenti i pjesës së tretë ka në qendër vëllain e Gjergj Kastriotit, fratin Reposh Kastrioti i cili i lutet Zotit në kishën françeskane të Malit Sinai, si Moisiu për popullin e tij të zgjedhur. Lutjet e At Reposhit paralajmërojnë, revanshin e Gjergj Kastriot Skënderbeut kundër Sulltan Muratit.

***

**ARGUMENTI DHE SHTJELLA TEORIKE**

Në dramë si vijim i sagës së Kastriotëve përfshihet Gjon Kastrioti i ri që mbyll rendin e princave arbër letrarizuar nga Mark Ndoja, në Aktin 5.

Tragjedia zhvillohet në periudhën e fundit të jetës së Skënderbeut duke nisur më vitin 1465 dhe kulmon më 17 janar 1468 në Lezhë, me vdekjen e Gjergj Kastriotit ndërsa Lekë Dukagjini vjen me fitore nga Shkodra në Kuvendin e dytë të Lezhës thirrur nga Skënderbeu, pasi kishte thyer turqit.

Tragjedia ka ruajtur formën klasike të melodramave në vargje model i shkruar nga Mark Ndoja edhe në vitin 1937 në tragjedinë në vargje "Ded Gjo Luli" si vijim i kësaj forme të zhvilluar së shumti në shkollën letrare katolike të Shkodrës që u ndoq edhe nga Et'hem Haxhiademi.

"Beteja e fundit e Skënderbeut" është rrethuar nga një mori personazhesh historikë, mitologjikë (Zana, Perri, Xhind) dhe fiction apo aktantë sikundër Papagali i Sulltan Mehmetit II. Prozodia e dramës është modeluar nga elementi eufonik për të krijuar një ontologji të mistikë ardhur përmes muzikalitetit të vargut përkrah aksionit dhe ritualit. Veprimi dramatik arrin një kulm ferik (luftarak) por pastaj vjen duke u fashitur në Aktin 5, sipas temës monumentale të procesioneve medievale të varrosjes së kalorësve me blasonierët e tyre. Në këtë Akt, drama merr ngjyrat elegjiake dhe dialogon me poezinë e varrezave. Gjithashtu në epilog ravijëzohet projektimi i njësisë nacionale ndonëse vihet në dyshim nga vetë zhvillimi i dramës dhe sidomos vargu i fundit që përfundon me mallkim.

Vargëzimi shquhet për masat dhe proporcionet strofike klasike dhe të rimuara. Metrat e vargjeve lëvizin nga 11 rrokshi në 7, rrokësh, dhe 5, 6 rrokësh, por ka edhe skandime të masave të tjera. Didaskalitë me shpjegimet para njësive dramatike, ndihmojnë për vënien në skenë të tragjedisë.

***

**KONTEKSTI HISTORIK DHE DISTOPIA: ZHVENDOSJA NË KOHË**

Argumetet bashkëshoqëruese të 5 Akteve shfaqen si pjesë të mendimit të përpunuar të autorit rreth dokumentacionit të shqyrtuar dhe autorëve si Marin Barleti e Fan S. Noli, për ngjarjet e fundjetës së Skënderbeut dhe të argumenteve të reja rreth kontekstit gjeostrategjik të kohës.

Në shekullin 15 Turqia, Venediku dhe Mbretëria e Napolit kërkonin kontrollin e principatës së Arbërit. Shfaqet pozita e veçantë e Lekë Dukagjinit dhe Tanush Topisë si trashëgimi politike e Skënderbeut, duke minimizuar rivalitetet e përmendura nga historianët mes principatave shqiptare.

Gjithashtu gjejne vend në dramë antagonistët e pushtetit të Skënderbeut si Ballaban Pasha, Jakup Arnauti e vasalë të tjerë të Sulltanit.

Në dramë shfaqen aspekte të kontrastit etik dhe të civilizimeve mes shqiptarëve dhe turqve: Kruja e Lezha nga asnjë anë dhe pallati i sulltan Mehmetit II në Stamboll me sallën e divanit. Rikonceptualizimi i leximeve si distopi letrare është një qasje e pasqyrimit të diktaturës e dhunës që sundonte në Shqipëri, ku po kryhej edicioni i revolucionit kultural kinez.

Shkrimi i tragjedisë si vijim i traditës letrare europiane, në vitin 1967 vendos skenën e Aktit 5, në Katedralen e Shënkollit të Lezhës, duke dialoguar: me profanizimin e kohës së shkrimit të sh. XX; me prishjen e trashëgimisë së besimit dhe rrënimin e monumenteve kultike. Në kontrast me atmosferën letrare e politike antieuropiane që buiste në Tiranë, në këtë tragjedi prifti At Dhimitri udhëheq ritualin për shpëtimin e heroit brenda Katedrales së Shënkollit shoqëruar nga lutjet korale të grave, ushtarëve dhe pleqve.

Me botimin e romanit në vargje apo eposit "Kastriotët" dhe të tragjedisë "Beteja e fundit e Skënderbeut" shkruar thuajse 50 vjet më parë për kremtimin e 500 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit, plotësohet nxjerrja në pah e një pjese të letërsisë Underground në Shqipëri, si alternativë gjalluese ndaj asaj ex zyrtare dhe Jubileut të papranishëm Kastriotian.

## ARGUMENTET E VEPRËS KASTRIOTËT

Praeludiumi

Invokacioni i Muzës së historisë, (Zana arbënore), parashkrimi epik i derës së Kastriotëve dhe i kronotopisë së zhvillimit të ngjarjeve. Ëndrra e Vojsavës dhe konceptimi i Gjergj Kastriotit në pallatin e Gjon Kastriotit në Krujë, rreth vitit 1403.

Në pjesën e parë (viti 1415), personazhet kryesorë janë Gjon Kastrioti dhe kunati i tij nga Pollogu, Dedosh Tribala, ndërsa luftimet turko-shqiptare zhvillohen në Kosovë (Suharekë, Kelm, Gjakovë) dhe Shqipëri.

Në pjesën e dytë (viti 1425), rimerret tema e kryengritjes së Gjergj Arjanitit dhe ripushtimit të jugut të Shqipërisë nga Evrenoz Pasha, që mbërrin me ushtrinë turke në Janinë nga Edreneja pas urdhrit të Sulltan Muratit.

Pjesa e tretë (viti 1443) personazh kryesor është Reposh Kastrioti, gjithashtu Gjergj Kastrioti, Hamza Kastrioti dhe Ati françeskan Ludoviko Loredani. Kjo pjesë dallohet për mistikën biblike, skenat e së cilës nisin në Ederne, vijojnë me Reposhin në kampin e Serasqerit Skënderbe në Siri, mandej Reposhi bëhet kallugjer dhe përshkon si profetët lumin Jordan, Jeruzalemin, shkretëtirën e Negevit dhe të Malit Sinai.

A
ARGUMENT

NGA ARISTOTEL MICI

***Vijon nga numri i shkuar***

Pjesë interesante e "Memories"që tërheq vëmendjen e lexuesve dhe sidomos të historianëve, është ajo kur Gjon Muzaka trajton figurën e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Ai e ngre lart atë si një personalitet të shquar, udhëheqës dhe komandant të talentuar. "Ky zotëri i përmendur ishte praktik në luftë dhe i guximshëm dhe u bë komandant dhe të gjithë i bindeshin ". Gjon Muzaka e përshkruan Skenderbeun si një kryeprinjës trim të vendosur që "gjithmonë me virtutet e tij, me guximin dhe mbrojtjen që u bënte zotërve të tjerë, u shkaktoi turqve shumë kërdira e pati shumë fitore, pa marë parasysh edhe humbjet e e zotërve dhe kalorësve tanë". "*Memoria*" e Muzakës na jep një informacion të saktë dhe bindës lidhur me kohëzgjatjen e luftrave dhe betejave te Skëndebeut: "*Lufta midis Sulltanit dhe Zot Skënderbeut vazhdoi e ashpër rreth 24 vjet, dhe mbas vdekjes së tij, vazhdoi me Zotërit e tjerë të Shqipërisë .....Zot Skënderbeu që i mënçur dhe trim, i priur të bënte mirë dhë që një zot i madh ndër të gjithë pararendësit e tij* " (f.49)

Muzaka, mbështetur ne kujtimet e tij, natyrshëm dhe pa emfazë tregon për kthimin e Gjergj Kastriotit ne Krujë: "....... në kohën e Muratit të dytë erdhi Skënderbeu, i biri i Zotit Gjon Kastriotit.......ky ishte dhënë peng prej të atit tek i përmënduri Murat me dy vëllezërit e tij, të gjithë të vëgjël. Dy vdiqën. Ai që quhej Gjergj Kastrioti, kur u bë turk (domethënë kur mori fenë muslimane) që thërritur Skënderbe që do të thotë në gjuhën turke Aleksandër dhe bej do të thotë zotërues. Ky, duke u rritur, arriti të marrë pozitë dhe ishte i zgjuar dhe trim. Si i vdq i ati, u arratis nga Sulltani , siç thuhet ishte dërguar me Pashanë e Rumelisë kundër hungarezëve. Në këtë fushatë Pashai qe thyer e ushtria turke ishte shkatërruar (3 nëntor 1443 ) dhe i përmënduri Skënderbe u arratis me të tjerët dhe, nga që desh fati, takoi të ishte me Qatipin e Pashait . Skënderbeu e kapi dhe e shtrëngoi t`i bënte një urdhër në emër të Sulltanit për qeveritarin e Krujës që t'ia dorëzonte vendin atij. Pastaj e vrau këtë kancelar që gjithçka të mbetej e fshehtë. Atëherë Skënderbeu vuri në udhë shqipëtarët e tjerë që ishin me atë, arriti në Arbëri dhe hyri në Krujë, i dha qeveritarit urdhërin dhe qeveritari ia dorëzoi ( qytetin ) atij. Të gjithë Zotërit e Shqipërisë u gëzuan shumë për ngjarjen dhe Skënderbeu që kthyer me një herë i krishter" ( f-20 )

"Pastaj thirri në një kuvend Zotërit e njohur të Shqipërisë në Lezhë. Kujt i shkoi personalisht (ta grishte) e kë e thirri me ane të dërguarish, kështu që i quajtur Skënderbe qe bërë udhëheqësi i tyrë në Shqipëri.......... ( po aty ). Kështu, siç del nga "Mëmoria " e Gjon Muzakës po edhe siç dihet nga të gjitha burimet e tjera historike, Skënderbeu më 2 Mars, 1444, thirri Kuvendin e Lezhës, ku u krijua bashkësia e princave shqiptarë me emrin "Lidhja e Lezhës". Skënderbeu u zgjodh kryetar i kësaj Lidhje dhe kapiten i përgjithshëm i ushtrisë [Capitaneus generalis].

"Dhe ky i përmenduri Skënderbe mori per grua të bijën e zot Arianit Ko-

*Në këtë pjesë, ku shtjellohet "Memorie", autori na tregon ato që na shpërfaqi në kohën e tij Muzaka për Familjen Skëndërbe, duke mos ia kursyer aspak kritikat por edhe duke treguar dhe anën e errët të vet…*

# Çfarë tregoi Gjon Muzaka për Skënderbeun dhe familjen e tij

mnenit dhe ky zot dergoi si dorëzanë Zot Gjinin, tim atë, pse ky i përmendur Arianit ishte kunati i tim eti dhe kishte për grua Maria Muzaka, të motrën e tim eti, siç thashë përmes të cilit qe përfunduar martësa. ( Skënderbeu u martua me Andronikën në vitin 1450 - shënimi ynë ) Dhe mori zonjën Andronika Komnennjatën për grua, e cila ishte kushërira ime dhe përdori më pas mbiemrin Skënderbega nga i shoqi.......dhe së fundi ky i lartëpërmënduri zotëri u shkaktoi shumë kërdira turqëve dhe pati shumë fitore [f 21].

Pastaj pasi kalon shpejt harkun kohor të betejave trimërore të Skënderbeut kundër turqëve, autori i Memories arrin në periudhën e fundit të jetës së heroit dhe shkruan për të: "Zoti Skënderbe duke parë se po i merrej fryma nga armiqtë dhe më pak shpresa, u sëmur nga ethet në Lezhë dhe vdiq në vitin 1466 [Në të vërtetë data e vdekjes së heroit është 17 Janar 1468 ] në moshën 63 vjeç. Mund ta merrni me mend se ç'pjesë e vendit kishte humbur me një kapiten të tillë......[f 21].

Po siç e thamë më sipër Gjon Muzaka krahas fjalëve shumë të mira e lavdëruese për kryetrimin e kohës, kur kujton disa veprime të Skënderbeut, që kishim për qëllim zmadhimin e principatës së tij në dëm të të tjerëve, ai mban qendrim kritik e mosaprovues. Gjon Muzaka , në këto kujtime , nuk e le pa e qortuar Skënderbeun, i cili për synimet e tij ndau Zanfina Muzakën prej Karl Topisë, dhe i dha atij të motrën e vetë, Zonjën Mamica Kastrioti.

Siç duket Skënderbeu po e kuptonte se për të përballuar sulmet gjithnjë edhe më të egra të sulltanëve, vendit i duhej një dorë më e fortë drejtuese. Në të vërtetë ai ishte kapiten i përgjithshëm i ushtrisë dhe në të njëjtën kohë kryetari i Lidhjes së princave shqiptarë. Ishte kështu i pari midis të barabartëve. Po kjo nuk ishte e mjaftushme. Duhej një dorë më e fuqishme, gati mbretërore, për të komanduar mbi anarkinë feudale ose mos bindjen e mvartësve. Në ndihmë të kësaj ideje, Fan Noli citon **Fallmerajerin**, me studimin e tij, kur shkruan: *"Skënderbeu tani ndofta e kishte kuptuar se pa një bashkim kombëtar të Shqipërisë së shpërndarë, lufta kundër turqëve nuk mund të vazhdonte me sukses [Fan Noli v.4 f.289-Tiranë 1989 ].*

Memoria e *Gjon* Muzakës ka një informacion real e të besueshëm edhe për familjen e Gjon Kastriotit. "Zoti Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut, zotëronte krahinën me emrin Mati. Po më pas Zot Skënderbeu u bë jo vetëm Zot i Matit, por u bë edhe Zot i Krujës, i Dibrës, i Brinjës, domethënë, i Randesit, i Tomonishtës, i Misisë dhe i krahinës së Jonimës dëri në det " ( f.48). Autori na jep qartë edhe mbiemrin e familjes së Voisavës, gruas së Gjon Kastriotit, nënës së Skënderbeut . Ai është i pari që jep mbiemrin e saj. "Dhe për më tepër ta dini që Zoti Gjon Kastrioti, i ati i Zot Skënderbeut, pati për grua zonjën **Voisava *Tribalda***, me të cilën bëri katër djem dhe pesë vajza."-( f.44 ). Dhë pastaj tregon me radhë sipas moshës emrat e tyre. Shenojmë se këtë pohim të princit Gjon Muzaka e përforcon dhe Im Zot Noli, kur e rikonfirmon se *Gjon Kastrioti ishte i martuar me Vojsavën, të bijën e kryezotit të Pollogut afër Tetovës. Kjo krahinë dukej që ishte pjesë e principatës balshiane dhe hynte nën influencën e Kastriotëve. Sipas dëshmimit të Gjon Muzhaqit, e ëma e Vojsavës ishte nga dera e Muzhaqëve.*[1] Ndërkohë, për



mbiemrin "Tribald" të të atit të Voisavës, duhet të përmendim , për këtë rast, edhe arsyetimin e një linguisti poliglot, **Zacharie Mayani**, i cili fjalën *Tribale*[2] si toponim dhe si llagap, e shpjegon me togfjalëshin "mal me tri maja",Tri-ball-e, po ashtu siç interpreton për analogji edhe toponimin e ngjajëshëm Trimal (Trimaja), pra shihet se edhe gjuhësisht , nga ana e rrënjës leksikore, kemi një fjalë me prejardhje iliro-arbërore, Tribald (*Tri-ball*).

Nga sa u tregua më sipër duket qartë që e ëma e Skënderbeut, Voisava Tribalda , vjen nga familje shqiptare dhe nga treva shqipfolëse, e Pollogut, zonë pas Tetovës, ku njerëzia dhe sot e kësaj dite flet shqip. Po çudia është se muajt e fundit kanë dalë studiues, që pikërisht në vitin 2018 , që është shpallur si Viti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, e gjejnë Nënën e Heroit me origjinë malazeze, gjë, që nuk e kanë thënë as Marin Barleti, as Marin Becikemi, as Gj. Muzaka, as i biri tij Kostandin Muzaka, as Dhimiter Frangu. Po le ta zëmë se këto zëra të rinj, që dalin në shtyp e në media, kanë burimet e tyre të reja, dhe prandaj dhe e bëjnë atë pohim; pyetja që mund t'ju benim këtyre biografëve do të ishte se pse pikërisht në Vitin simbolik të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dalin deklarime të tilla për gjenealogji emrash historikë? Dhe kjo ndër kohë, kur rusët, fjala vjen, nuk kanë shqetësime pse Katerina e Madhe ka prejardhje prusiane, po ashtu anglezët nuk shprehin merak pse në Kurorën e tyre Mbretërore ka gjak gjerman, po ashtu dhe italianët, as dje edhe as sot, nuk e kanë vrarë aq shumë mendjen pse Perandori i tyre, Viktor Emanueli III e kishte marrë gruan e vet , Helenën, nga Mali i Zi, ndërsa disa *studiues* tanë sot nuk i zë gjumi deri sa të konfirmojnë qe Nëna e Skenderbeut qenka malazeze.

Duke lexuar Memorien e Gjon Muzakës, dallojmë se ai vazhdimisht të atin e Skenderbeut e shkruan Gjon Kastrioti. Në onomastikën shqiptare, ky emër, emri i përveçëm **"Gjon"** është një emër shumë i lashtë dhe unikal, mbase përtej kohës biblike, i asaj kohe, që nuk mbahet mend, që kur një i ri vritej aksidentalisht dhe trupi i kthehej në shpend, siç e shikojmë te legjenda e Zogut Gjon. Në këtë legjendë vëllai me emrin Gjini (i bërë shpend edhe ai nga dëshperimi ) thërret të vëllanë pikëllueshëm pa mbarim"Gjon, Gjon, Gjon"……me shpresë se do ta gjejë. Mirëpo ,është për të ardhur keq, që në kundërshtim me këtë traditë të stërlashtë iliro-arbërore, historiani Oliver J.Shmitt [3]në një libër të tij, të atin e heroit tonë kombëtar, Gjon Kastriotin, na e shkruan me trajtën sllave **Ivan** Kastrioti. Natyrisht, një veprim i tillë, që cenon idenditetin etnik të një personi historik , siç është rasti në fjalë, lëndon sedrën e çdo shqiptari, duke krijuar dhe një ndjesi alergjie. Natyrisht zoti Oliver J. Shmitt , si historian që është, këtë trajtë emri të sllavizuar, nga **Gjon** në Ivan, nuk e ka bërë nga naiviteti, po i shtyrë nga prirja e tij shpërfillëse për Gjon Kastriotin dhe të birin e tij, Skenderbeun.

Një burim tjetër informacioni gjejmë tek Memoria edhe për flamurin kombëtar të Shqipërisë, për flamurin tonë më fushën e kuqe dhe shqiponiën e zëzë dy krenare. Siç e kemi thënë edhe më parë në një studim tjetër, Memoria e Gjon Muzakës dëshmon lashtësinë e këtij flamuri që nga viti 1372, kur perandori i Bizantit ia dhuron figurën e kësaj steme Andrea Muzakës së Dytë, Despotit. Gjatë shekujve ky flamur u bë simboli i bashkimit të shqiptarëve. Ashtu ai ka qënë dhe është pjesë e ndërgjegjes kombëtare për të gjithë shqipëtarët, si për ata që janë brënda kufijëve politik të Republikës së Shqipërisë dhe për ata që janë jashtë Atdheut .

Në këtë trajtesë duam të ndriçojmë sadopak edhe mesazhin etik si edhe nivelin kulturor të asaj kohe në shoqërinë shqiptare, ashtu siç del dhe nënkuptohet me anë të kësaj "Memorie". Lë të nisim me një detajë të faqes 40 të saj, kur autori flet për gruan e tij dhe tregon se si ajo vjen nga shtëpia e Dukagjinëve. Pastaj vazhdon prap për Dukagjinët... "Thuhej se origjina e tyre vinte nga "Trojanët". -Janë a po s`janë Dukagjinasit me prejardhje trojane për synimin tonë në këtë shkrim ka pak rëndësi. Ne na tërheq vëmendjen në këtë rast vetëm fakti që përmëndet fjala "Trojanët". Pra, të paktën nëpër oborret e princave tanë flitej e shkruhej për Trojën dhë trojanët. Atëherë pra, kur flitej e shkruhej për trojanët e Trojës së largët në kohë pse të mos diskutohej edhe për Athinën, për Spartën e spartanët, për Romën e Romakët, ashtu siç shkruan Gjon Muzaka vet për flamurin e Jul Qezarit dhe të Oktavjan Augostit në faqën 53 dhë 54 ,detaje këto që flasin për nivelin kulturor të shoqërisë elitarë shqiptare në kohën e Skënderbeut.

Në "Memorien" e Gjon Muzakës të tërheq vëmendjen edhe mendimi i përparuar etik i autorit, që tregon një njeri të qytetëruar, të mënçur e largpamës: "Atë që mund ta bëni me paqe mos e bëni më luftë" ,"Atë që mund ta qortosh fshehur mos e ndëshko publikisht". Kurse për fushën e jetës politike ai shkruan:"Njeriu që me anë të forcës është bërë Tiran, është më mirë të kthehet në një skllav të së drëjtës." Mbi të gjitha këshillat morale të Gjon Muzakës shquajnë porositë e tij për diturinë dhe arsimimin e fëmijëve: "Prindi që e lë birin e tij të mësuar, por të varfër, thuajse i ka lënë gjithçka, por ai që e lë të pamësuar edhe të pasur , thuajse nuk i ka lënë asgjë". Më këtë fjalë Gjon Muzaka ndez qiririn e parë të iluminizmit në Shipëri qysh në fillim të errësirës së sudimit turk.

Dhe kështu me mesazhin etik dhe nivelin kulturor të elitës shoqërore shqiptare në Mesjetë, që shprehet në "Memoria" të Gjon Muzakës, mbyllim trajtesën tonë për këtë vëpër historike të kohës së Gjergj Kastriotit, Skëndërbeut.

## Gjon Muzaka dhe "Memorie" e tij

Gjon Muzaka, i biri i despotit të principatës së Muzakajve, Gjin Muzaka, në vitin 1510 ka lënë me gjalljen e vet një gjenealogji të fisit të tij princëror. Vepra është e llojit të veçantë dhe e shkruar Italisht në kushtet e emigracionit. Kur Gjon Muzaka shkroi këtë "Memorie" ishte koha që po flitej për organizimin e një kryqëzate antiturke. Autori i saj ka pasur për qellim kryesor t`u tregonte bijve të tij kufijtë e pricipatës, që, po të ktheheshin rishtas në trojet e tyre pas ikjes së turqve, të dinin se ku i kushin trevat e krahinat, të cilat u përkisnin si trashëgim. Në të njëjtën kohë ai deshte t'u bënte të ditur trashëgimtarëve të tij edhe se me cilat familje të asaj kohe kishte pasur të bënte principata e tyre. Disa nga dyert e fiseve të mëdha, ku ata ,Muzakajt, kishin pasur lidhje krushqije, farë e fisnije dhe përzierje gjaku , kishin mbetur pa trashëgimtarë, kështu që tokat dhe pronat e tyre duhej t'u jepeshin bijve të tij. "Memoria" e Gjon Muzakës u zbulua për herë të parë nga historiani gjerman Karl Hopfi në bibliotekën *Brankacine* të Napolit në vitin 1863. Mbas 10 vjetësh ai e botoi të plotë në vitin 1873 në librin "Kronikat Greko-Romane [*Chroniques Greco-Romane*, - Berlin 1873"]

***Shënime***

*[4] F. Noli, Vepra, 4, f. 497*

*[2] Z. Mayani, The Etruscus begin to speak, Simon and Schuster, NY, f. 337*

*3 Oliver Jens Schmitt është historian zviceran i lindur në Basel 1973*

*Çdo fundviti, sipas një rituali gati matematik, komunikimi me Visarin dhe bashkëshorten e tij bëhet i gjallë dhe i ndjerë për të kthyer në jetë Atjonin...*

K
KRIJIM

# NGJYRA DHE RITME TË RRITJES ME RIMA SI PUTHJE…

*(fragmente)*

ESE NGA EDA ZHITI

**T-R-O-K-I-T-J-E…**

Sa herë trokiste dera në shtëpinë tonë, teksa shkoja ta hapja, do më duhej të kërceja sa andej këndej në majë të gishtave mes lodrave pafund, që vogëlushi im me emrin Atjon, kishte përhapur nëpërkudo. Duhej të bëja kujdes të mos shkelja asnjërën prej tyre.

Në kthim, pra nga dera e jashtme deri në sallon, vajtje-ardhje, ndodhte që Atjonin ta gjeja të hipur mbi aparatin e televizorit, që e mbanim ulët, drejt e mbi dysheme. Madje e gjeja dhe të shtrirë sipër tij, me kryet plot kaçurrela të varur para ekranit për të parë më nga afër, duke u bërë kështu pjesëtar në ndodhitë, sepse *Charlie Brown* po adoptonte *Snoopy*-n. Ishte ende më vështirë ta hiqje nga ai përqendrim "përsipër televizorit", kur shfaqeshin Tomi e Xherri. Me Zorro-n më ndryshe...

Trokitjet, besoj, i zgjuan kërshërinë, teksa lodrat, dihet, që të shtojnë argëtueshëm dëshirën për veprim, fantazinë e aftësitë. ndërsa ekrani i televizorit ishte, si të thuash, një si lloj ftese nga bota jashtë, ku krahas merakut tim, duhej dhe përkujdesi i veçantë.

Siç duket ato prapësi aq gazmore i ndiente më fort duke i parë kokëposhtë. Ndonjëherë hidhte vështrimin nga lodrat përreth, aq të shumta, mes rrëmujës të të cilave gjendeshin kasetat e videos me po ata personazhë, librat fletë-trashë sa biskotat apo dhe plastikë, që e shoqëronin të voglin tim në vaskën e dushit e pluskonin nëpër valët që i krijonte me duar duke i përplasur hareshëm.

Kështu do të ketë ndjerë praninë e detit dhe të varkave.

Pastaj mes lodrave u shtuan dhe fletët e vizatimit dhe ngjyrat, që do të kalonin nga gishtat e Atjonit deri dhe në mure si gjurmë veprash arti… që nga zhgarravinat e këndshme e te portretet, llojet e kafshëve, sendet, peizazhet etj, sa vendosëm të hapnim një "ekspozitë shtëpiake", ftuam fëmijët e pallatit, jo vetëm të familjeve të ambasadës.

Njëri nga vizatimet, ai me Shenjten Nënë Tereza, e bëri kur ishte tre vjeç e gjysmë, iu botua dhe shkruajtën dhe gazetat.

Poezia për Atjonin filloi si lojë, kështu besoj. E ngazëllente rima, siç thotë dhe Visari në njërën nga poezitë këtu.

*...Dhe një fjalë çfardo*

*hidhje për ta rimuar unë.*
- Sa më do?
- Sa gjithë bota, më shumë.

…Ndërkohë bëra dhe unë një fletore "Fjalori i Atjonit", ku shkruaja në dy kolona fjalët. Në të parën si i shqiptonte e në tjetrën fjalën e saktë, se ndryshimi mund të ishte i ndjeshëm.

Nuk ka fjalor më të bukur në botë se ai i fëmijëve, kur përpiqen të shqiptojnë fjalët, ato duhet të ketë qenë paraket, që më pas ne i kemi kultivuar në formën e sotme.



Familja Zhiti, si gjithmonë të tre bashkë

**…KRISHTLINDJA DERI NË VITIN E RI**

ishte koha më e bukur për mua, kudo që të ndodheshim. Më pëlqenin shumë rrugët e pasditeve të vona, të zbukuruara me drita pafund dhe ecejaket e njerëzve, ngarkuar plot me dhurata feste. Bashkë me Evën, time motër, por dhe me Visarin e Dashin, paketonim dhuratat, ja ashtu fshehurazi dhe pak përpara mesnatës së Krishtlindjes, i vendosnim pas derës së jashtme, prapë fshehurazi, ca më vonë krijonim rastin dhe njëri nga ne trokiste fort te dera, sërish fshehurazi, ndërkaq thërrisnim plot gëzim: "Erdhi Plaku i Krishtlindjes". Atjoni dhe Kaltra rendnin tek dera jashtë plot ngazëllim dhe tërhiqnin zvarrë dhuratat që ishin më të mëdha se ata vetë.




Mes lodrave të shumta, veglave muzikore, teleskopit të madh që ia dhuroi im vëlla, Ariani, ia solli nga Amerika, nuk duhej të mungonin librat, përralla e legjenda, që nga ato shqiptaret e ballkanikët e deri te ato në Veri, "Bambi", "101 dalmatët", etj.

Më vonë Atjoni më tregoi se së bashku me Kaltrën e kishin zbuluar se si vinin dhuratat, por gjithsesi u pëlqente kjo lojë. A do të duhej ta vazhdonim po ashtu?

Më mirë të bënim një ekspozitë të re. Dhe ku? Në kopshtin para shtëpisë, pikturat i varëm nëpër degët e pemëve dhe në përurim ftuam gjithë kalamajtë e lagjes…

Atjoni rritej shpejt dhe bukur. Mbaroi shkollën filloren "Ylber" në Tiranë dhe kërkonte këngë apo himne, madje njëri prej tyre doli dhe në një nga botimet e shkollës. Ndërsa vizatonte me hope. Por kërkonte të bënte ndonjë nga kopertinat e librave të babit, atë të gjyshit patjetër.

Por ishin dhe muret. Ashtu si në Romë që i llangoste, në Tiranë po i pikturonte dhe po i shkruante, edhe në anglisht. I erdhi radha dhe derës, ku vizatoi një trup femre e shkroi fjalën "Trokit".



Përpara syve kishim fëmijën, por dhe djalin e rritur në të njëjtën kohë. Po donte mëvetësinë. Më duket se ia kërkuam ne që fjalës 'Trokit', t'i shtonte 'Trokit-je në zemër', që të merrte dhe kuptime të tjera…

Puna na çoi përsëri në Romë dhe Atjoni bëri ca vite shkollë atje, mbaroi dhe klasën e parë në Liceun Klasik, të famshëm në të gjithë Italinë, "Giulio Cesare", nisi latinishten dhe greqishten e vjetër, por gjimnazin e përfundoi në Tiranë, në "Ismail Qemali", nga që u kthyem. Fillimet e ndryshimeve ishin të vështira për atë si andej dhe këndej, por vinte dita që ai i tejkalonte duke i shtuar shokët dhe shoqet, edhe sot i ka, jo vetëm në Romë e në Tiranë.

Kujtoj kur erdhi një herë dhe më tha: "Mush, e di ku ndryshon liceu në Romë nga gjimnazi në Tiranë?". Ma trego – iu përgjigja gjithë vëmendje. "Ndërsa në lice na mësonin të mendonim, këtu na detyrojnë të mësojmë përmendsh". Mbeta. Por dhe u ndjeva mirë me arsyetimin e ftohtë e të prerë të tij. Do të më duhej të lajmëroja arsimtarët…

Shumë shpejt u afrua koha për të shkuar në universitet. Zgjodhi jo nga ato çfarë do të donim ne dhe nuk u luhat për asnjë moment: F.I.L.O.Z.O.F.I.

Nga Milano, ku studionte, do të na shkruante se kishte zbuluar "mrekullinë e studimit".

Atjoni papritur botoi esenë e parë, pastaj të dytën, dërgoi të tretën… dhe i vinte keq që s'kishte dhe aq kohë, gjithë ditën në bibliotekë, sa të shkonte dhe andej nga Akademia "Brera" në Milano për të parë se si pikturohej.

Po qeshja me vete, kur një pasdreke në shtëpi, ndërsa shfletoja një libër të Elias Canetti-t, "Gjuha e shpëtuar", rilexoja vizimet, përshkrimin që ai i bënte nënës së vet, kur ajo i fliste për familjen e saj me emër të mirë dhe po përfytyroja librat e tim biri, ku ai do të bënte humor me mua, pasi dhe unë kisha rrëfime të tilla.

Dhe ne vërtet botuam një libër me shkrimet e Atjonit 19 vjeçar, që u prit mjaft mirë nga lexuesi dhe kritika.

…Po sa sukses patën në ekspozitën e Tij, që u përurua në Universitetin "Polis" në Tiranë dhe në albumin që iu botua më pas! I vlerësuan këtu e jashtë vendit.

Dhe çuditërisht Visari i vazhdoi poezitë dhe më vonë, në Vatikan, në Uashington, ku na çoi puna, sikur Atjoni të ishte ende fëmijë me ne, shtoi të tjera, pjekurinë, dhimbjet e mungesës, yllësitë.

…Vizatimet e Atjonit mbeten po ato, mrekulli fëmije për ne, tani e përgjithmonë.

…po ua dhurojmë bashkarisht poezitë dhe pikturat, që dhe pse nuk janë bërë enkas për to, japin gjendje të përbashkëta plot dritë… kam bindjen se do të pëlqehen nga ju, që në shtëpitë tuaja rrisni fëmijë, por dhe nga ju, të rriturit, që ruani brenda vetes fëmijën, një lloj *Piter Pan*-i tuajin. Cilëtdoqofshi. S'ka gjë më të rëndësishme, deri në shenjtëri, se sa të rritësh nga dashuria fëmijën dhe vetveten, se ritmi i saj, fjalët dhe ngjyrat, që gjithsesi rimojnë ashtu si puthjet prindërore,

Konsiderojeni si një… *trokit-je në zemër.*

# 9 POEZI PËR ATA/O QË RRITEN







Nga Visar Zhiti

## BUZË DETIT

Deti blu
me dallgë shumë,
pulëbardha këtu
ç'do nga unë?

Për guacka erdha,
t'i mbledh një nga një,
të bardha, të verdha,
në çantë do t'i vë.

Mbi tryezën time
do t'i shpërndaj,
do bëj vizatime
me guackat pastaj.

Një lule, një zog
dhe fytyrën e mamit,
një kalë, një maçok
dhe fytyrën e babit.

Krahët i hapa
si në përqafim.
Lashë ndër guacka
nga një premtim

Pulëbardha këtu
ç'do nga unë?
Deti blu,
me dallgë shumë.

Vlorë, 03.11.1999

## TOM & JERRY

Tomi dhe Xherri
ç'(ar)miq gazmorë.
Plasi sherri
në oborr.

Vrapon Tomi,
Xherri vrapon,
copërlohet atomi
në emocion.

Dalin nga ekrani,
ku bëhet *sikur.*
Është dhënë alarmi
të qëndrosh si burrë

Kjo lojë gjithkund
ashtu ne na fton.
Xherr jam unë
e ti je Tom.

Pastaj ti - Visar
e unë – At'jon.
Kupë fitoresh gjithë ar
hëna mbi ballkon.

Së bashku ta lëmë
egoizmin pis.
Tom-Xherr-u-bëmë
të paqes, harmonisë.

## HIMN TJETËR, TANI PËR MARTIRËT

- ...që do ia jepja, ashtu si Atjonit, fëmijës më të parë
që do të takoja në rrugë në Shkodër
pas meshës së lumturimit... -

A mban kryqi
më shumë se një jetë?
38 martirë,
38...

Ranë mbi baltë,
u ngritëm mbi retë,
38 martirë,
38...

Yje u bënë
pikat e gjakut të nxehtë,
38 martirë,
38...

Kthehen shpirtrat,
i dërgon Qielli vetë.
38 martirë,
38...

Nga ballet e tyre
Goglota zbret,
38 martirë
38...

Nga sytë e tyre
rrjedh agimi i qetë,
38 martirë,
38...

Flatrat e lumturimit
tundin përjetë,
38 martirë,
38...

...fund vjeshte, 2016



## LUAJ SA MË SHUMË

Dil, luaj shpesh e më shpesh!
Gola bëj që rrjeta të tundet.
Nëse fitoni, buzëqesh,
por mos u tall me atë që do mundet.

Edhe humbja s'është e keqe,
i jep tjetrit shansin të fitojë.
Rëndësi ka të futesh në ndeshje
që të forcon e do t'emocionojë.

Vazhdo lojën, të tjera, bir,
tenis, shah, shëtitje në park.
Duhet loja, kur është e mirë,
veç jo "kush shurrën hedh më larg".

Vrapo, vrapo, kaloja vetes,
mos beso se do të merret fryma.
Bëji të gjitha lojat e jetës,
veç mos luani me pështyma.

Të shoh në varkë lumit që rrjedh,
në kanotazh u mëshon lopatave,
teksa qielli nga sipër hedh
vezullime në ngjyrën e patave.

Koha është lumë, - thonë filozofët, -
dhe ti i fatit lundërtar.
Kolonë të bëhesh në mes të shqotës
dhe të digjesh si një far.

Washington, 29.06.2018

## RRATHËT DHE NUMRAT

Rrathët në trungjet e pemëve
tregojnë vitet.
Numëroi, numëroi me ëndje
dhe shih si bota rritet.

1, 2, erdhi buzëqeshja e vërtetë,
3,4, u shtuan fjalë të bukura
5,6,7,8...
vite dhe numëra.

Ah, rrathët ashtu nëpër trungje
sa shumë më trishtojnë!
Pse i prenë pemët, gjithë kjo humbje,
blerimet si retë ku shkojnë?

E dua pemën të rritet, të rritet,
të pleksen degët me dëshirat.
S'dua rrathë prerjesh për vitet,
por numra për frutat, me mijëra...

Ç'rrathë hapen të kaltër mbi ujëra
Kur një gur hedhim n'thellësira.
Kështu të hapet, pa urdhra,
Lajmi i mirë dhe vetë e mira.

## FLAUTI MAGJIK

Kutia është hapur dhe flauti po pret
frymën tënde që mrekullisht i jep jetë.

Gishtat e tu prej ere ato vrima si plagë
i kthejnë në perla që shkëlqejnë varg.

Pret flauti magjik të ringjallet sërish,
nga yjet të rrjedhin shira melodish.

Flauti qiellor, flauti i tim biri,
flatra zogjsh ngre kaq hijshëm nga hiri.

Petale shumëngjyrëshe shkund sipër nesh,
fluturojnë ndjenjat me kuaj prej resh.

Shshshttt! Qetësi! Një statujë është ngritur,
Flauti nisi vetë që të kumbojë papritur...

*Afër mesnatës, 29.06.2018*

## SORKADHE DRITE

Vendosa të shkoj
te drita më e madhe
që ta ftoj
ja, si një sorkadhe.
A druhet drita?
E ledhatoj me dorë.
Jo më kot prita
te shtegu hyjnor.

Brirë prej rrezesh
te shpella natore.
Pelerina shenjtësh -
mjegulla mbi hone.
Mbi sorkadhe drite,
thashë, do të vij.
Po s'pati mahnitje,
as dhe dashuri,
hiçi shket mbi botë,
në shpirt - zbrazëtira.
Bëhu një pikë lot,
lot që lëshon drita!

## TELESKOPI I ATJONIT

Teleskopi im më pret në ballkon,
Sa i heq mbulesën, qiejt m'i afron...

Arusha e Vogël, Arusha e Madhe
Yllësitë varen porsi portokalle.

Ja, Udha e Qumshtit, Kashtë e Kumtrit, ja,
si një klithmë habie një yll se ku ra.

S'mbaron universi, duhet ndërruar lentja!
Luftrat ngjajnë kot, kot edhe urrejtja.

Prapë një meteor ra në dorën time,
Natë misterioze, natë mrekullie!

Por ngrihen avionë, raketa kozmike,
Ëndërr e njeriut, sa larg që ti ike!

Tutje, andej, thellë, ku është përjetësia...
Shpirtrat kthehen prapë, ah, i pret shtëpia!

## MOS VALLË KE RËNË NË DASHURI?

Se ç'të ka kapur një si heshtje,
që duhet të jetë dhe mënçuri.
Të pashë që befas buzëqeshe,
mos vallë ke rënë në dashuri?

Se ç'shkruan dhe menjëherë e fshin
në mur, në derë, por dhe në trup:
Sy të misterit, një shkrepëtimë,
flokë hëne derdhur mbi një sup.

Vazhdimisht bëhesh më i bukur
dhe më i dashur vazhdimisht.
Shenja blu... kush të ka puthur,
jo veç në qafë, por dhe në shpirt.

Po, po, ke rënë në dashuri!
Ah, dashuria s'është rënie,
është ngritje e yllë, lartësi
në qiejt mahnitës të një ëndrre.

Nga dashuria vijmë në jetë
edhe jetojmë me dashuri.
Fati të jetë si të jetë,
dashuria vetë është përjetësi.

*Një metaforë e bukur e autorit e shtjelluar në një tregim, që është punuar kohë më parë..*

T
TREGIM

# SKIFTERËT E HOTEL RITZ

NGA ROLAND GJOZA

Maria Magdalena Junior mori në telefon security guard, zotin Rodriguez, ish fituesin meksikan të luftes me gjela dhe e lajmëroi me urgjencë se, në dhomen e saj të pritjes, kishin hyrë ca zogj të mëdhenj dhe i kishin rrëmbyer paruken e mbasdites, atë të orës gjashtë, kur ajo frekuentonte librarinë Barnes & Noble. Rodriguez, një rondokop me mustaqe të ngritura lart e të përdredhura me sqimë u ngjit lart me ashensorin e rezervuar për raste dhe e gjeti zonjën Blu, sepse kështu kishte qejf ta quanin, në gjendje paniku. Ajo mbante pëllëmbët e duarve mbi tullën e saj në formën e dardhës dhe dridhej me fërgëllima dhe përpëlitej duke lëshuar herë pas here klithma të vogla.

Në dhomën e saj të pritjes kishin hyrë vërtet skifterët, shpend të mëdhenj me pupla të gafrruara të zeza në kafe të errët dhe me një mbresë të bardhë prej reje në caponjtë leskra - leskra dhe në nën kthetrat e në një pjesë të kraharorit. Ai i priti me duar, se ata, sapo e pikasën, iu vërsulën me brafullimë, e çorrën në fytyrë dhe në duar. Ai mezi u shkëput prej tyre, mbylli derën me forcë pas vetes dhe ia mbathi për në dhomën e gjumit të zonjës, që tashmë po qante.

— Oh, ç'paskeni hequr zonjë e nderuar. Ishin skifterë, shpend shumë të rrezikshëm. Duhet lajmëruar policia.

— Vritini, ç'prisni, Rodriguez!

— Jo, zonjë, në Amerikë nuk lejohen të vriten shpendët, po as kafshët. Ha burgun. A, po të ishim në vendin tim, tjetër punë. Unë vras mendjen si kanë ardhur në hotelin Ritz, në hotelin e famshëm të Nju Jorkut. A e dini se sot në ora tetë të mbrëmjes këtu organizon një parti Madona? Ç'parti, o zot, ata, sa ta marrin vesh se këtu ka skifterë..që të sulmojnë pa një pa dy..shiko si më kanë bërë zonjë, për pak sa s'nxorra pistoletën..po kam tre fëmijë... Nuk është parë në këtë hotel të vjetër kaq aristokratik, një mynxyrë e tillë.. Kam 21 vjet që punoj këtu.

— Ç'pret, Rodriguez, vriti!

— Jo, zonjë, as që bëhet fjalë!

— Ik Rodriguez, mos të të shoh bojën!

— Më fal, zonjë!

Ish kampioni i luftës me gjela ia kishte mbathur.

Policia mbërriti menjëherë. Ishin ca djem të rinj, të gjatë e të hollë, të armatosur gjer në dhëmbë. Bashkë me policinë erdhi zjarrfikësi, që shërbente për raste emergjencash mjekësore. Pastaj u duk menaxheri i madh, zoti Comming, tejet i shqetësuar.

Në dhomën e pritjes me dritare të hapura e me perde pambuku me pikturat e Tahitit të Gogenit, perveç erës që fëshfërinte dhe dritës lëbyrëse që hynte nga Central Park, nuk bënte majë asgjë tjetër.

Maria Magdalena Junior ishte një milionere vejushë që shkruante romane bestseller, po kohët e fundit kishte kaluar një krizë hipokondrie dhe kishte harruar që ato romane i kishte shkruar vetë. Ajo po përjetonte një rast absurd që mund të zgjatej në kohë, sipas mjekëve, ishte shndërruar nga shkruese e palodhur, në lexuese dembele. Kjo puna e skifterëve nuk i kishte ngjallur asnjë farë asosacioni, sado të largët. Po veç tmerr dhe panik të paskaj. Kur po shkruante romanin "Kënaqësi për kënaqësi", ajo kishte zgjedhur për personazhet e saj katin e fundit të këtij hoteli të njohur. Që atëherë kishte mbetur aty, se i pat pëlqyer. Nga dritaret shikonte Central Parkun. Jeta e saj bënte rotondë, kishte qejf ta përdorte këtë fjale, nëpër hotele historike të Manhattenit. Brenda në ato fole mondaniteti përplot befasi intime, ishin ngjizur dramat e saj të trëndafilta.

Policia, siç erdhi, iku, ashtu papandehur. Gjithashtu dhe zjarrfikësi, pa lëshuar sirenë. Ajo mbeti krejt vetëm pa kuptuar asgjë. Dhoma e pritjes ishte e qetë. Dritaret ishin mbyllur. Me duart që i dridheshin, shkroi një protestë për The New York Times, që u botua të nesërmen. Fill pas saj ia behën reporterët e gazetave të mëdha dhe të televizioneve, shkrimtarë, biologë, ambientalistë, turistë, dashnorë, shoqata të shumta për mbrojtjen e kafshëve, fotografë të pavarur, madje dhe skenaristë dhe regjisorë të njohur të Hollivudit. Fax News, ABC, SNN transmetonin kronika nga apartamenti me skifterë i shkrimtares Maria Magdalena Junior.

Ishin 12 a 13 skifterë, që kishin zënë vend në një bazament ngjitur me pullazin, pranë një skulpture të vjetër të luçiferit gati për të fluturuar. Njerëzia rrinin poshtë në park dhe vështronin lart dritaret e zonjës Blu, e cila ndjeu tronditshëm, me një ndjenjë poshtërimi, cënimin e privacisë. Në orët e paradites skifterët prindër gjuanin pëllumba në park me një furi të frikshme. Ishte një skenë aspak e këndshme, po gjithsesi dramatike, që lëshonte alarmin e një paniku. Pëllumbat e mbytur rreshtoheshin lart në bazamentin e gjatë dhe skifterët e vegjël i shqyenin me një pangopësi rrëqethëse. Puplat binin poshtë ngadalë me një mbresë shpirtrash të munduar. Atje poshtë, pas një gardhi që vendosi policia, njerëzit, sa vinte e shtoheshin me shpejtësi. Teleskopë, aparate fotografikë, kamera, ishin në punë dhe natën. Përgjohej jeta e një familjeje të madhe skifterësh në mes të Manhattanit.

Zonja Blu priste me radhë njerëz të famshëm, që kërkonin prej saj t'i lejonte të shikonin skifterët nga afër. Po ajo gjithmonë kundërshtonte me nervozizëm, se e gjithë kjo i dukej një marrëzi.

Oh, ç'është gjithë kjo kotësi, nuk e kuptoj se si mund të rrinë me orë të tëra për të parë me dylbi skifterët, këta shpendë grabitqarë që i shfarosën gjithë pëllumbat, gjeraqinat, mëllenjat, shkurtat, shapkat, pulëbardhat e Central Parkut. Skifterët jetojnë larg në vetminë e maleve, rrafshnaltave dhe rrafshultave të humbëtirave, fluturojnë në thellësi të qiejve dhe me sytë e fortë tejpërshkues këqyrin pulën në bar, miun e arës, urithin, lepurin, iriqin, këndezin kokoroç mbi gardh, ulen gati pa rënë në sy me një shpejtësi të pa rrokshme dhe rrëmbejnë rrufeshëm prehën me çaponjtë e fuqishëm, pasi e godasin furishëm me sqepin si thikë. Këto sillte nëpër mend ajo, ndërsa vejevinte nëpër dhomë si e rrjedhur.

Pronari i hotelit iu lut ta linte apartamentin, po ajo e kishte parapaguar atë për tre vjet. Ai i premtoi t'i jepte trefishin, veç të largohej prej andej. Ç'kishte ndodhur? Një ekip i njohur biologësh të Universitetit të Kolumbias donin të vinin aty e t'i kthenin dhomat e atij apartamenti në laboratore investigimesh dhe analizash gjenetike. Po ishte krejt e pamundur t'i mbushje mendjen zonjës Blu, që kishte vendosur të drejtonte një fushatë kundër tiranisë dhe terrorit që mund të vijë dhe prej shpendëve. Ajo u distancua nga njerëzit poshtë dhe i kërkoi qeverisë të merrte masa për të mbrojtur të drejtat e saj.

Një milion njerëz në ditë mbushnin cit më cit parkun e madh të Nju Jorkut për të parë skifterët. U ndje menjëherë kriza e shitjes së biletave në Muzik Hollet e Broduejt, në Metropolitan Opera, në Gugenhaim Galery, në MoMa, kinema, teatro, restorante, bare, se tani njerëzit blinin vetëm kamera, aparate fotografikë, dylbi dhe fast food për të ngrënë.

Firmat e këtyre të fundit u solidarizuan menjëherë me popullin poshtë, që donte të vazhdonte kjo shfaqje e rrallë, ndërsa hotelet e mëdhenj; Hajat, Marriott, Sheraton,që po boshatiseshin, se turistët preferonin të flinin përjashta në dritën e hënës, gjithashtu manjatët e artit, producentët e famshëm, u bënë zëdhënës të kërkesave të zonjës Blu, që skifterët të hiqeshin prej andej.

Një ditë u shfaqën, e bija legjitime dhe i biri jashtë kurore, të cilët, pasi vunë në dukje me një delikatesë të përkore bjerrjen mendore të nënës së tyre, pritën bujtës kundrejt një pagese marramendëse në dhomën e pritjes. Pastaj ia behën nipërit dhe mbesat me një lukuni nga pas. Hotel Ritz ishte më i preferuari. Ai prenotohej me orë. Një orë 1000 dollarë. U ndërtuan dhoma shtesë, zyrat dhe kthinat e pastrueseve, rrobalarëseve, hekurosësve, depot dhe një pjesë e lavanderisë, u kthyen në dhoma fjetjeje.

Atje në dhomën e pritjes rrinin njerëz me skafander e kundragaz dhe skifterët u qëndronin mbi kokë, mbi krah, fluturonin rreth tyre, fotografoheshin, xhiroheshin nga operatorë të shkathët, viheshin në gjumë, u merrnin gjak, u lidhnin kordele te këmbët, e shi aty këmbeheshin si në një katastrofë lufte, apo gjueti peshkaqenësh në oqean, regjisorë dhe biologë, gjenetistë dhe rioshë të karrierës biblike, egjiptologë, aventurierë të showbiz.

Maria Magdalena Junior bleu një paruke të re dhe si zakonisht në ora gjashtë zbriti për të lexuar në librarinë Barnes & Noble. Atje ajo mësoi se perëndia Mut e egjiptianëve ishte simbol i amësisë në kohën e Gizës, se ajo përfaqësohej nga një kokë skifteri, gjithashtu bëri çudi kur leçiti se skifteri është një shpend hemafrodit. U rrembush rrufeshëm me një feksje të çuditshme, hem mikluese e hem të marrëzishme dhe filloi të shkruajë romanin më të ri me temën e një çifti hemafroditësh, duke nxjerrë si përfundim me një kënaqësi të dyshimtë përplot fërgëllime frike, se Maria Magdalena, gruaja biblike e Jozefit, nuk e ka lindur Jezu Krishtin me frymën e shenjtë, po nga sperma e panjohur që ka ardhur nga qielli, ndoshta prej skifterëve në kohën e afsheve turbulluese dhe krejt rastësisht i ka lagur vaginën. Prejardhja e Jezuit nga një çift hemafroditësh, për më tepër nga një ngjizje e çuditshme me skifterët, e magjepsi aq tepër, sa e bëri që ta shkruajë romanin vetëm për 14 ditë, në një gjendje pothuaj transi. " Zonja e paturpshme, perëndia Mut" pati një reklamë të madhe te The New York Times, që kushtoi 250.000 dollarë dhe një parapagim nga shtëpia botuese prej 5 milion dollarë, të cilat ajo ia dhuroi shoqatës ndërkombëtare të mbrojtjes së kafshëve.

Një ditë asaj i trokiti në derë një xhuxh me mantel të zi .Ai mbante cilindër të zi, flokët e përdredhur i vareshin përanash mbi veshët e dalë, tejet llapushë, kundërmonte zgjyrë, dhëmbët, kur nënqeshi ligsht, iu dukën që tej që ia kishte zverdhur mungesa nostalgjike e pastës dhe e furçës së dhëmbëve.

— Vishu me kostum, qethu, lahu, pastro gojën, hidh parfum dhe pastaj mund të të pres. Ti sikur vjen nga ndonjë strofull qelbësi. Shko, mos më shiko me ata sy të frik-



shëm.

Ai i tha emrin. Ajo e njohu. Hapi derën dhe e futi brenda. Shaminë e mbante te hundët.

— Romanin tënd do ta ekranizojmë. Skenari është shkruar. Xhirimet fillojnë nesër. E njoh mirë tipin tënd eksentrik. Ti në fillim thua, jo. Gjithmonë, jo.

— Edhe tani them, jo. Po ty s'të kundërshtoj dot, se je pasardhës i një populli të pamposhtur. Nuk ta duroj vetëm erën. Prandaj po të them, po. Bëni ç'të doni.

— Me 1 milion je e kënaqur?

— Nuk është keq. Vetëm m'u shporr sa më parë, se do të nxjerr zorrët.

Xhuxhi iku. Ajo i la hapur tapat e parfumeve.

Ditët e verës ishin të mbushura me pamje nga më të çuditshmet; skifterët e vegjël bënin përpjekje për të fluturuar. Ndonjëri prej tyre binte poshtë dhe ngecte në degët e pemëve, atëherë turma alarmohej për fatin e tij; jehona e kësaj ulërime rrëqethëse ndjehej gjer në dhomën e punës së Blumbergut, kryetarit të Bashkisë së Nju Jorkut. Ai çohej dhe shikonte mbi parkun e Siti Holl-it dhe mendonte i alarmuar, se ç'mund të kishte ndodhur, sikur skifterëve t'u qe tekur të zinin parmakun e dritareve të zyres së tij. Kështu nga larg, ai lakmonte pa shumë joshje, po tejet i emocionuar, pasurimin e shpejtë e të rastësishëm të pronarit të hotelit Ritz. Atje ishte dhe një farë shkrimtare, që e pëlqente shumë e shoqja, e cila kishte shkruar së fundmi një roman të famshëm. Ajo ishte në fund të karrierës, madje ca e rregjuar, po fati i kishte rezervuar një surprizë të forte, skifterët te dritarja. Megjithatë nuk do të qe dhe aq e bezdisshme, pothuaj e padurueshme, përkundrazi, ëmbëlsisht përfituese, madje, se ata do t'i vlenin ndoshta për një ekzibicionizëm mediatik, pikërisht tani në mandatin e tij të tretë, sikur t'i kishte, ah, sikur t'i kishte, ja, aty ngjitur dhe, pse jo, t'i shfrytëzonte paq për ambicien e fundit.

Pothuajse të njëjtën gjë mendonte dhe guvernatori Paterson, që ishte i verbër dhe gjithmonë fshehtas e kishte stimuluar një fuqi mistike për plotësimin e tij.

Kjo prirje vihej re dhe në turmën e pafund që ndiqte përditë gjer në hollësitë më banale jetën e skifterëve. Ishte vërtet për t'u habitur, se si ata i kishin lëshuar vezët në parmakun ngjitur me pullazin e hotelit Ritz, fare pranë luçiferit, që dukej sikur ishte bërë gati për të fluturuar. Kjo joshje instiktive e miliona njerëzve, në të gjithë Amerikën, shi prej atyre skifterëve fare të rastësishëm, 12 a 13 skifterëve, si të vënë me dorë në atë mjedis të huaj për ta, por me parandjenjën e një kodi, sikur bënin përpjekje me anë të një sinjali, të ngacmonin genin njerëzor për të shpallur një mister të madh, që pritej të shfaqej prej disa mileniumeve, por që po vononte.

Dhe në kohën që turistët ishin shtuar shumë, çmimet e biletave të avionëve kishin pësuar një rritje marramendëse dhe për aty ishin dyndur dhe magët e Tibetit, madje dhe eremitët e malit Athos për të deshifruar shenjat dhe për të rënë në trans që t'u shfaqej Zoti për një kumt të vetëm, të mezipritur, skifterët qenë zhdukur një mëngjes papritur, gati misteriozisht.

Pandehmat ishin nga më të ndryshmet, po ajo që vihej re tek të gjithë me një ndjenjë të fortë dramaciteti, ishte zhgënjimi i madh. Çdo gjë shkoi në vendin e vet me vështirësi, po secili humbi diçka esenciale, pritjen e habitshme të diçkaje të jashtëzakonshme që dha shenjë, po që s'u shfaq.

Hotel Ritz u boshatis ndërkaq. Central Park ra në fashë dhe qetësi duke pritur, jo pa fërgëllime, vjeshtën e parë.

Maria Magdalena Junior, ose siç kishte qejf ta thërrisnin, Zonja Blu, u rrëgjua edhe më shumë, përplot maniera, bjerje kujtese,vajza dhe nipi jashtë kurore, bashkë me shpurën e tyre, avulluan, me shenjat dalldisëse të dafrungave dhe orgjive të pafundme, ndërsa Rodriguez, roja e sigurisë, ish kampioni meksikan i luftës me gjela, kishte çfarë t'u tregonte bujtësve, shenjat e çaponjve të skifterëve në fytyrë dhe në duar, gjë, që ta mbushte mendjen, se ata kishin ekzistuar.

Pastaj dhe një hollësi që doli nga goja e një fëmije, po që nuk e dëgjoi njeri; Ata ikën ngaqë të vegjlit mësuan të fluturojnë? Po ku shkuan? A do të kthehen përsëri?

A
ARGUMENT

*Ballkani sot nuk e ndjen shumë ekspansionin e politikës turke, prej rrugës që ka hapur kultura e saj, ku shikuesit janë gjithnjë e më të shumtë prej zgjidhjeve racionale alla Ballkan dhe problematikave gati identike në rajon. Po në të gjithë këtë hulli, a mund të ketë një kontroll moral të njerëzve që i marrin këto filma, pasi historia jonë po transformohet në një farë mënyre pa u ndalur drejt perceptimeve të tjera, kurse imazhi i Turqisë historike po na vjen i qashtër dhe i këndshëm dhe duket po e zhbën krejtësisht atë errësirë që na la me vetëdije të plotë...*

# Shqiptarët, me filmat turq, po *rregullojnë* dhe historinë

**NGA BEN ANDONI**

Historia e Mesjetës shqiptare ka pasur ndriçimin e disa prej penave më të njohura historike evropiane, përveç kontributit vendas, që ka hedhur dritë mbi të. Në kohët tona, përveç prof. Pëllumb Xhufit, të ndjerit Prof. Kristo Frashërit dhe Prof. Oliver Jens Schmitt, e një sërë autorësh të tjerë, i shtohen studiuesit e njohur të fillim shekullit të shkuar me Milan Shuflajn dhe të tjerë para tij, që elaboruan tema por edhe ndriçuan dokumente mbi të cilat u hodh dritë. Pavarësisht kësaj, një "Histori të Skënderbeut" të plotë, të paktën si e pretenduam, e patën



të plotësuar vetëm pas viteve '90 nga profesorët Frashëri dhe Schmitt, pas punëve jo të plota që ishin bërë nga një sërë dinjitarësh tanë dhe të huaj në të shkuarën. Në një areal të njëjtë, por gjithsesi në shekujt e mesëm dhe të fundit të Mesjetës kemi shikime shumë komplekse me metodologji interesante të prof. Xhufit dhe një sërë kolegësh të tij, që Schmitt i shtyu edhe disi më parë në shekujt para pushtimit osman.

Kjo hyrje në fakt nuk është shteruese por thjesht disi përshkruese e asaj ose burimeve nga ku mbështetej dhe ndërtohet narracioni dhe kultura jonë e përgjithshme për Osmanët dhe pushtimin e tyre, por edhe ndikimin e jashtëzakonshëm për fatet e vendit tonë, si edhe shikimin e Skënderbeut etj.

Shumë vite më vonë, në dy dekadat e fundit, publiku i gjerë, mu ai që ka pak akses ndaj burimeve historike dhe studimeve, po e plotëson kulturën historike me ekspansionin e paparë të filmave turq. Dhe, ndodh që personazhe që deri më tani i kemi marrë përmes kësaj historie të hartuar me metodologji shkencore, të egër, të pamëshirë dhe që e kanë rrënuar hapësirën e vendit tonë, tashmë përmes filmografisë turke, që e ka pushtuar tregun shqiptar, na vinë të paqëm, mendjehapur, kurse imazhi i Perandorisë Osmane i qashtër. Të mendosh si një hapësirë e bukur, ku shqiptarët ishte një bahçe thjesht pak e harruar e saj.

Të gjithë këto seriale, modifikuar për interes të ligjërimit të lidërshipit të ri turk, që përmes tyre, po përcjell ekspansionin e vet kulturoro-historik dhe dilemën për atë peshë jo të pakët që kanë mbajtur shpatullat e njerëzve tanë, zonave tona të origjinës, të ngjallin vërtetë pak trishtim. Paçka se nivelin e tyre shpesh spekulativ e mbysin efektet dhe kostumet, që për hir të së vërtetës janë të mrekullueshme, bashkë me skenat, fotografinë, aktorët shumë të paraqitshëm dhe elementë që bashkohen dhe i japin jetë idesë. Një sërë personazhesh të egër dhe të paskrupullt të historisë po na vinë nga këto filma mbushur me cilësi të bukura që përcjellin dashuri dhe paqe por edhe urrejtje për të huajt e këqinj, që zakonisht u përvishet pabesisë së katolikëve dhe perëndimorëve. Përveç shtëpiakeve që mbushin jetën me to, njerëzve në lokalitete që i kanë të vetmet argëtime, por edhe hapjes së madhe në të gjithë Ballkanin dhe më gjerë, ato po përcjellin indirekt ndjesinë e urrejtjes, vrasjes dhe xhelozirave të pafundme. Kjo është jeta, mund të përgjigjet një regjisor dhe një ithtar i tyre e derisa i duan njerëzit, pse të hyn në punë?! Në fakt, tema jonë është ndryshe. A munden personazhet turq historikë të vinë të tillë te ne kaq lirshëm dhe pa një lloj filtri të nevojshëm moral. Asesi censurë. Paçka se Mehmet Pushtuesi po na vjen si model i përkorë, që mbron Ortodoksinë, ndërsa po i bën varrin Bizantit, që është degjeneruar!! Shpata e Drejtësisë është vetëm mbi të, ashtu si i atribuon vetes sot drejtësinë presidenti aktual turk Erdogan.

Dhe, kjo nuk mbaron këtu. Për filmat e kohëve tona, të habit sesi personazhet e shumta të telenovelave turke që mbrojnë shoqërinë nga e keqja përballen në çdo hap me vrasjen dhe të keqen. Një aludim i pastër për fuqinë e Turqisë dhe misionin e saj, që e ka nisur me Neo-Otomanizmin. Të mendosh, shoqëria jonë, me të cilët eksperimentohet deri në absurd, e hapur për çdo ndrydhje identiteti, me këto filma duket se është duke ridimensionuar mënyrën sesi e shikon vetë jetën. Më saktë një segment jo i pakët i popullatës, që argëtim të vetëm, kanë pikërisht filmat turq dhe propagandën e frikshme të kryeministrit tonë dhe baltosjen e përhershme të Opozitës.

Dhe, të kthehemi sërish te Mehmet Pushtuesi, filmi i ri që po *ngërthen* shqiptarët para Tv: Të merr lemeria kur kujton se në histori ai ka shkatërruar pa fund hapësirat tona dhe tashti përshfaqet një hero për vetë ne. Si për ironi të së gjithës, vjen i interpretuar nga një prej aktorëve më simpatikë të Turqisë, në mos gaboj nga një *spekulim* me origjinë shqiptare, bashkë me të gjithë hiret mashkullore dhe përveç kësaj sfidues kundër të keqes që e përbën... kryqi.

...

Ndërkohë Shqipëria ka nevojë për kinematografi cilësore, që turqit sot e kanë interesante dhe sfiduese. Por, gjithsesi edhe këtu kemi një armik, që quhet treg. Kujtesa e njerëzve të sotëm nuk shkon më larg se shtëpitë e tyre dhe mbase kjo është arsyeja që ekspansioni nuk ndalet dot, nëse nuk gjen dot një alternativë artistike. Shqipëria e ka të pamundur ta mbushë këtë boshllëk me fuqinë e saj ekonomike dhe atë që ofron për kulturën.

Filmat turq, në një llogari që është bërë vjet prej "Sabah", ka të ardhura që shkojnë në rreth 350 milionë USD, ndërkohë që gati një dekadë më parë eksporti televiziv turk numëronte të ardhura në rreth 1 milion dollarë, në transmetimet që sot gjenden të shtrira në më shumë se 100 vende, përfshi këtu edhe Shqipërinë. Dhe, me këto shifra Turqia renditet në prodhuesin dhe shpërndarësin e dytë në botë të serialeve televizive, pas SHBA-së. Kjo nuk mbaron këtu, pasi shumë shpejt, shifra mendohet të dyfishohet.

Ballkani sot nuk e ndjen shumë ekspansionin e politikës turke, prej rrugës që ka hapur kultura turke, ku shikuesit janë gjithnjë e më të shumtë prej zgjidhjeve racionale alla Ballkan dhe problematikave gati identike në rajon.

Në fund, ajo që na mbetet të themi është e thjeshtë: Në të gjithë këtë hulli, a mund të ketë një kontroll moral të njerëzve që i marrin këto filma, pasi historia jonë po transformohet në një farë mënyre pa u ndalur drejt perceptimeve të tjera, kurse imazhi i Turqisë historike po na vjen i qashtër dhe i këndshëm dhe duket po e zhbën krejtësisht atë errësirë që na la me vetëdije të plotë.

(*Milosao*)

## ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht më e dobët se një numër më parë. Zoti Aristotel Mici na kish sjellë një shkrim që organizohesh mbi historinë e gjetjes dhe gati na kish bërë një review të "Kronikës së Muzakajve", një botim i zbuluar shumë kohë më parë dhe që për herë të parë jep konfigurimin e Familjes "Kastrioti" por edhe të familjeve princërore shqiptare. Shkrimi mund t'i shërbente shumë njerëzve që nuk e dinë historinë për të, por kurrsesi historianëve dhe të tjerëve që e njohin si vepër. Qëllimi, nga ajo që na la vetë të shkruar autori, ishte që "Memoria" e tij t`u tregonte të bijve kufijtë e pricipatës, që, po të ktheheshin rishtas në trojet e tyre pas ikjes së turqve, të dinin se ku i kishin trevat e krahinat, të cilat u përkisnin si trashëgim. Zgjidhja e redaktorit duket pak e çuditshme, por kur e gjykoi ftohtë e gjeti si të paarsyeshëm vendosjen në krye.

Redaktori shkroi diçka lidhur me marrëveshjet e përbashkëta Kosovë-Shqipëri dhe elementët e tjerë që i lidhin të dy vendet, por edhe që mund t'i ndihë ku theksoi se Kalendarët e përbashkët nuk është se i kanë dhënë frymë impakti artit në të dy vendet, kurse shihet se rrugët e Kosovës dhe Shqipërisë janë të ndara në art dhe madje ka frymë që nuk i qas qysh në bashkëpunimin esencial. *Lufta e marketingut për të shpallur vlerat dhe për t'u afirmuar me anë të tyre në një farë mënyre kërkon që të shmangen shumë gjëra. Dhe, pa asnjë mëdyshje dhe ato që kanë lidhje me patetizmin e memorandumeve...*

Në një shkrim që sillte kujtimin e 88-vjetorit të lindjes kujtuam prof. Alfred Uçin me një shkrim të botuar prej tij në disa numra të gazetës "Albania" në vitin 2004. Në ndryshim me pjesën më të madhe të krijimtarisë të tij të gjerë shkencore dhe publicistike, ku trajtoi kryesisht probleme filozofike, estetike, probleme të teorisë, së letërsisë dhe të kritikës letrare, ky shkrim i drejtohet një auditori shumë të gjerë, sepse tërheq vëmendjen për një aspekt shumë të rëndësishëm të jetës së të gjithë njerëzve: Leximi dhe humbja e interesit për librin. Faqosja e shkrimit ishte gati katastrofike.

Kurse Eir Plasari na solli një frymëmarrje të bukur me ciklin e poezive të saj, që na dha leje për t'i botuar dhe po kështu cikli i bashkëpunëtorit tonë të përhershëm Demir Gjergji, i cili na solli frymëmarrjen e tij lirike me një grup të zgjedhur nga krijimtaria e vet.

Redaktori i tregoi kujdes dhe kompozitorit të njohur shkodran Zef Çoba dhe punës me bashkëpunëtorët e tij që po korrin rezultatin e punës së palodhur të përbashkët të një grupi muzikor të mrekullueshëm brenda një shoqate muzikore, teksa organizon shfaqje prestigjioze ngado....në vend dhe jashtë tij.

Patëm vërejtje për redaktimin e shkrimeve dhe sidomos pjesëmarrjen, vërejtje që deridiku qëndrojnë. Pa dashur për të bërë një inter mea culpa brenda mea culpës së madhe, ka vend shumë për korrigjime, por kushtet na sfidojnë dhe mbi të gjitha motivimi. Layout nuk ishte aq i mirë.

R
REVIEW

*Çmimi i Panairit të 21-të duket se do ta shtyjë dhe më tej autorin, që shkrimtaria mund ta ndihë edhe për tema shumë më sfiduese, ku metaforat t'i shërbejnë përditshmërisë sonë. Libri duhet vlerësuar për grafikën e realizuar nga OMBRA GVG dhe kjo e fundit edhe për sfidën e saj të bukur, që të sjellë një autor, që realisht premton për letrat shqipe...*

# "CIKLOPI"

NGA STAF MILOSAO

Kur u përmend në këtë vit në kronikat mediatike, shumëkush pyeti se cili ishte Brajan Sukaj, autori fitues i çmimit për Librin më të mirë në Panairin e 21 të librit. Në fakt, ai nuk ishte i panjohur për njerëzit e librit dhe ndërkohë romani i tij në dorëshkrim "Viti i Elefantit" doli në short-listën e Çmimit Kadare. Në fakt, te "Ciklopi", libri fitues, autori e tregon se ka bërë një punë të mirë drejt përsosjes të zejes së shkrimtarisë, ndërsa në stilin e një autori tejet kërkues vepron pa identifikime personazhesh apo kohësh drejt faktit për të shpërfaqur një përmbajtje ideore. I vetmi handikap në veprën e vet është padyshim, që miksimin e kohës duhet ta bënte edhe me leksikun përgjegjës, por edhe me identifikimin e personazheve dhe situatave me këtë regjistër. Gjithsesi romani i tij të bën ta lexosh me intensitet si kërshëri dhe si ide për të parë realisht sesi zhvillohen personazhet, që janë shumë pak, por që në vetvete i japin veprës dramaticitetin e njohur për të mbajtur linjën dhe për ta përcjellë atë si duhet.

Kur e merr në fillim ke ndjesinë se po kap një motiv të njohur të Fitzexherald, por autori bie shpejt në një regjistër tjetër, që duhet thënë se e tregon autor të formuar dhe madje gati për tema më të ndjeshme. Nga ky roman, ti ke ndjesinë e një autori që shkruan mirë dhe që ka shumë pretendime për veten dhe tematikat e tij.

Pika e nisjes së romanit është mirëfilli e një motivi të Fitzexherald. Një fëmijë me probleme ka lindur në një familje dhe çmeritjes së gjindjes i përballen dashuria e të ëmës që e mban të birin me tipare të çuditshme të mos e shohin njerëzit. I vogli i lindur i shpërfytyruar me shtatë gishta, nofulla të mëdha dhe sy të shkëlqyeshëm është vërtetë i frikshëm, por jo për të ëmën. Dhe, nëna e re zgjedh sakrificën, atë që bën çdo nënë duke e mbajtur të birin me kushtet shumë të mjerueshme që e rrethojnë. Një moment kur sëmuret doktori i këshillon kininën, ndërsa gruaja për ta gjetur duhet të vjedhë.

Autori e administron mirë procesin gjyqësor ndaj fatkeqes, që të kujton turmën tonë dhe të cilën ai duhet ta ketë pasur bajagi në mëndje, ku dëshira për ta dënuar është e pareshtur dhe shumë e egër. Në vetën e tretë narratori kryesor, që mbetet vetë autori, shikon gjithçka qetë dhe pastër. Megjithëse, presioni i madh nga të gjithë anët për gjyqtarin që i shkon deri në shtëpi, ai e mposht me zërin e arsyes që shkon te Drejtësia, ku gjykatësi indirekt tregon se një nënë që vjedh për fëmijën e saj nuk mund të jetë kurrsesi hajdute. Dhe, kjo kafshëri e gjindjes







### Ndjesia e librit

Kur e merr në fillim ke ndjesinë se po kap një motiv të njohur të Fitzexherald, por autori bie shpejt në një regjistër tjetër, që duhet thënë se e tregon autor të formuar dhe madje gati për tema më të ndjeshme. Nga ky roman, ti ke ndjesinë e një autori që shkruan mirë dhe që ka shumë pretendime për veten dhe tematikat e tij...

e merr një përgjigje, sepse qyteti përfshihet nga flakët si një ndëshkim jo i vogël prej panginjes.

Libri është i ngritur mbi një metaforë dhe shkrimtari pavarësisht se nuk e ruan gjithherët regjistrin e kësaj metafore na zbulon mirë subjektin e tij, që duhet thënë se është i veçantë dhe autori ka meritën se e respekton me të gjitha mundësitë në këtë regjistër. Kur merr librin kushdo mund të mendojë prej titullit se ka një referencë të letërsisë klasike antike, gjë që në një farë mënyre mund t'ia atribuosh një pjese të personazhit të tij, vetmisë së madhe të personazhit të tij dhe përpjekjes që kjo qenie të identifikohet, por që të gjithë duan ta mbysin. Fatkeqësisht personazhi ynë nuk ka forcën e tij, por ka njësoj forcën e ndëshkimit. E kjo e bën dhe titullin shumë të goditur dhe njëherë autorin një njeri me ambicie jo të vogël. Çmimi duket se do ta shtyjë dhe më tej autorin, që shkrimtaria mund ta ndihë edhe për tema shumë më sfiduese, ku metaforat t'i shërbejnë përditshmërisë sonë. Libri duhet vlerësuar për grafikën e realizuar nga OMBRA GVG dhe kjo e fundit edhe për sfidën e saj të bukur, që të sjellë një autor, që realisht premton për letrat shqipe.

Opinioni i Ditës

# Ndryshimet në qeveri, shuplaka e dalë huq

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)



...që ai e konsideroi si një shuplakë. Lëvizjet që ai vendosi t'i shpallë këtë fund viti ishin kontradiktore, të amullta dhe pa sens.

Megjithëse në formë ato kanë pamjen e një shock-u që është i barasvlershëm me rrëzimin e qeverisë (po të shtosh dhe ikjen e Xhafajt vetëm 3 nga ministrat e kabinetit të pas zgjedhjeve kanë mbetur në detyrë), ato rrezikojnë mos përçojnë asnjë kumt drejt publikut.

Askush nuk mund të ketë vërejte për largimin e Lindita Nikollës, kundër të cilës dolën në rrugë me mijëra studentë, por askush nuk mund të kuptojë gjithashtu se si ministrja rrëzohet dhe ligji i arsimit të lartë, i përpunuar dhe vënë në zbatim prej saj, qëndron.

Mos vallë Rama ka ndryshuar mendim 180 gradë, duke pretenduar tashmë se fajin nuk e ka më sistemi po njerëzit?

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Damian Gjiknurin emri i të cilit u përfshi në skandalin e 40 milionë eurove (për 2 km rrugë) tek Unaza e re. Ç'kuptim ka të bjerë Gjiknuri dhe projekti i vjedhjes të vazhdojë njësoj si më parë?

Askush nuk e di pse po largohet Ditmir Bushati kur marrëveshja me Athinën e çuar drejt fundit konsiderohet nga Rama si sukses, apo kur ai është në të njëjtën linjë me partnerët e BE kundër idesë së shkëmbimit të kufijve Kosovë-Serbi?

Askush nuk e kupton pse Arben Ahmetaj u bë kokë turku, kur sipas shefit të vet ekonomia është rritur, punësimet janë shtuar dhe fuqia blerëse është ngritur.

Në thelb, këto ndryshime tregojnë përrallën tashmë të konsumuar të peshkut që qelbet nga bishti.

Sipas saj, Edi Rama është personazhi pozitiv i kësaj fabule ku ai gjithmonë gjendet i rrethuar nga njerëz të këqij.

Në mandatin e parë mëkatarët ishin aleatët e tepsisë që duheshin larguar. Edhe atëherë qeverisja qe e shkëlqyer, por të vetmet njolla ia linin LSI dhe PDIU.

Më pas fajin e kishin drejtorët e hipotekave, të legalizimeve dhe të spitaleve që turbullonin ujin që rridhte i pastër nga maja.

Erdhi protesta e studentëve dhe faji tentoi të lihej tek rektorët e dekanët që shumë shpejt u evidentuan si servilët e kryeministrit.

Edhe me këto ndryshime, njësoj, Rama po tenton të përçohet mesazhi se fajtor është pothuaj gjithë kabineti, ndërkohë që lideri po e çon vendin drejt sukseseve të reja.

Vetëm kështu mund të shpjegohet fabula paradoksale e një qeverisjeje të mirë, por me 8 ministra që ikin.

Këtë alibi askush nuk mund ta besojë.

Madje, ata studentë që dolën në rrugë dhe ende nuk kanë arritur as të ngrenë buxhetin e arsimit, as të ulin tarifën e masterave, as të kenë kartën e studentit dhe as të abrogojnë ligjin që i ka pjellë të gjitha problemet, kur të rikthehen në Tiranë kanë më shumë arsye të protestojnë se sa patën kur e nisën në fillim të dhjetorit.

Sepse të gjitha sa ndodhën që prej rebelimit të tyre treguan se problemi që kanë është një njeri i vetëm.

Nëse para për arsimin nuk gjenden, sepse ato duhet të shkojnë tek oligarkët edhe pa praninë e Gjiknurit, nëse tarifat nuk ulen edhe dhuratat fiskale për të pasurit vazhdojnë edhe pa Ahmetajn, nëse në universitete gjithçka do të jetë si më parë edhe pa Nikollën, problemi inture është i drejtpërdrejtë me kryeministrin.

Këto ndryshime tronditëse të qeverisë shërbyen së paku vetëm për një gjë. Për t'i bërë të kuptojnë studentët dhe të gjitha shtresat e revoltuara, se mes tyre dhe Ramës nuk ka më asnjë digë, se nëse flasim për shuplakë, ajo nuk ka asnjë vlerë pa rënë mbi fytyrën e tij. Dhe me sa pamë në asamblenë e PS këtë të hënë, ajo ende është një dorë e mbetur në ajër.




Dje në 'Deutsche Welle'

# Presidenca rumune e BE-së - Kolaps me pasoja?

Nga Robert Schwartz

(vijon nga faqja 1)

...dhe Strasburgun... Në këtë formë, ose pak më ndryshe mund të shkruhen kryetitujt e gazetave në ditët e ardhshme në mediat e ndikuara prej PSD-së në Bukuresht. Kështu disa ministra nën drejtimin e kryeministres, Viorica Dancila shpresojnë se mund të hyjnë edhe në librat e historisë. Me tone nacional-populiste dhe kritike ndaj BE, e urta Viorica Dancila ka zbatuar pa iu dridhur syri urdhrat e atij që tërheq fijet në prapaskenë, të kreut të partisë të dënuar, Liviu Dragnea nga PSD.

Ajo dhe shpura e saj do t'ia tregojnë vendin europianëve të tjerë pa moral dhe hundëpërpjetë, do t'u tregojnë se si bëhet politikë në Rumani dhe për Rumaninë, për këtë janë të bindur përkrahësit. Ajo, Viorica Dancila, rumanishtja e së cilës shfaq boshllëqe të ndjeshme e që gati përditë kthehet në objekt humori në media, ajo, që njohuritë e gjuhëve të huaja i ka ekzistente vetëm në letër, që ngatërron para kamerave, Podgoricën, kryeqytetin malazez me Prishtinën, do t'i tregojë vendin Merkelit, Macronit, Kurzit, e të gjithë të tjerëve, kolegëve europianë, emrat e të cilëve ajo nganjëherë i harron. Të paktën këtë e ka lënë të kuptohet në Bukuresht. E që gjithçka të bëhet me vetëbesim të plotë, pak ditë para ndërrimit të viteve, ajo u kurorëzua nga portali propagandistik rus, si "figura politike rumune e vitit". Dashakeq kujt i shkon mendja për të keq...



Megjithatë...Dragnea, Dancila e të tjerët nuk i sjellin dot dëme BE-së. Vendimet e mëdha të gjashtëmujorit të parë 2019 e anashkalojnë Rumaninë. Brexit dhe zgjedhjet europiane janë gati të mbyllura, e as nuk mund të ndikohen e as nuk ndërrojnë drejtim nga zhvillime të papritura të presidencës rumune. Edhe sikur ekipi qeveritar të tregohet antieuropian, ka edhe një president, Klaus Iohannis, një europian liberal i bindur, që mund ta kthejë timonin në drejtimin e duhur. Këtë ai e ka bërë disa herë me sukses e do të vazhdojë ta bëjë. Edhe nëse Dragnea e kërcënon me padi për tradhti ndaj atdheut.

Pra, nga këndvështrimi i politikës së brendshme, duhet parë se si do të zhvillohet lufta e brendshme mes presidentit të parlamentit, Dragnea dhe presidentit të shtetit. Afrimi është i përjashtuar, po ashtu edhe fundi i mungesës së stabilitetit politik nuk dihet.

E çfarë do të ndodhë me presidencën rumune para këtij sfondi? Në Bruksel, thuhet se ajo mirëpritet. Qeveria në Bukuresht është shumë e zënë me veten, për të thyer porcelanët e kushtueshëm të BE. E lëre më të arrijë të ngrejë më këmbë diçka konstruktive...Para krizës së vazhdueshme alla rumunçe, presidenti i Komisionit Europian, Jean-Claude Junkcer mund të filojë të paketojë, e në këtë kohë të shijojë edhe një samit "historik" në Siebenbürgenin piktoresk. Sibiu, vendlindja e presidentit Iohannis, në qendër të medias si epiqendër europiane këto muaj nis edhe rrugëtimin drejt librave të historisë së BE. Me Dragnean, Dancilan e të tjerët si figura episodike, që mund të gëzohen për qilimin e shtruar tek Sputnik e bashkëshoqëruesit...Kështu është falë Europës!






## HOROSKOPI

### DASHI

Inkurajimi dhe mirënjohja që prisni më në fund do të vijë. Njerëzit po presin për t'ju dhënë ndihmë sa herë që keni nevojë për të. Një shëtitje me miqtë mund t'ju frymëzojë.

### DEMI

Ju dhe miqtë tuaj ose anëtarët e familjes po i afroheni një kohe shumë të pazakontë në jetën tuaj. Mendoni në mënyrë të guximshme, dhe shikoni se si të gjithë reagojnë ndaj një ideje më aventureske se zakonisht.

### BINJAKET

Keni pasur disa ide të mrekullueshme, por ka ardhur koha që t'i konkretizoni ato. Hidhni një vështrim mbi mendimet e vjetra, sepse prej tyre mund të dalin plane shumë interesante.

### GAFORJA

Sot kushtojini vëmendje njerëzve të cilët nuk pranohen lehtë nga shoqëria ose e kanë të vështire të gjejnë veten me të tjerët. Sa i përket dashurisë, mësoni të lëvizni me ritmin e zemrës.

### LUANI

Ndonjëherë njerëzit që i duam na thonë gjëra që nuk duam t'i dëgjojmë, por kjo quhet sinqeritet. Këshilla e tyre mund të jetë e padëshirueshme, por ata vetëm po përpiqen të ndihmojnë. Ju ende mund të ecni përpara me idetë tuaja.

### VIRGJERESHA

Nëse jeni gati të aktivizoheni në një projekt ose aktivitet grupi, thjesht fillojeni dhe energjia juaj do të përputhet me detyrën dhe do t'ju çojë përpara. Puna me të tjerët do t'ju ofrojë një shpërqendrim të shkëlqyeshëm nga gjërat që ju kanë trazuar mendjen.

### PESHORJA

Lidhje befasuese do të shfaqen në të gjithë hapësirën tuaj sot. Mundohuni të mos përqendroheni shumë thellë brenda vetes tuaj. Përpiquni të krijoni kontakte të reja interesante.

### AKREPI

Me hijeshinë, mëshirën dhe inteligjencën tuaj, ju do të ndërtoni një urë të përsosur me miqtë sot. Ekzistojnë tre anë në çdo histori: ajo e një shoku, ajo e kundërshtarit dhe e vërteta.

### SHIGJETARI

Ju keni shumë pushtet mbi njerëzit e tjerë sot. Ndoshta mund të jetë hijeshija juaj, mund të jetë ndikimi juaj financiar, ose mund të jetë thjesht fat i pagabueshëm. Cilado qoftë arsyeja, ju mbretëroni sot.

### BRICJAPI

Duhet të ruani energjinë për gjërat më të mëdha dhe më të mira që po vijnë drejt jush. Jeta nuk është një garë, kështu që ngadalësoni pak. Mos ndërmerrni asnjë projekt të ri dhe përpiquni të shmangni ndonjë angazhim të madh sot.

### UJORI

Disa persona duan të dinë idetë tuaja rreth asaj se si duhet të jetë lëvizja e tyre e ardhshme. Nëse habiteni nga kërkesat e tyre, mos u habisni. Ata ju admirojnë më shumë sesa ti e kupton.

### PESHQIT

Gjithçka ka të bëjë me nxjerrjen e llojit të duhur të energjisë sot, kështu që duhet të merrni një kthesë vetëmohuese dhe të projektoni imazhin që dëshironi. Ka energji pozitive të thellë brenda jush, dhe është koha që ta lini atë të shkëlqejë.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISE, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al